



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare

(UDHËZIMET PËR RAPORTIM)

Verzioni 4.0 (SRTN)

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (UDHËZIMET PËR RAPORTIM)

DEPARTAMENTI I STATISTIKËS

DHJETOR 2019

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	6
HYRJE	8
QËLLIMI I SRTN	8
BAZA LIGJORE.....	8
KONFIDENCIALITETI	8
PËRKUFIZIMET	8
KËRKESAT DHE AFATET KOHORE TË RAPORTIMIT	11

Shtojcat

SHTOJCA 1: Model i urdhërpagesës për bankat komerciale	16
SHTOJCA 2: Kodet e SRTN-së me përshkrim të shkurtër	18
SHTOJCA 3. Kodet e SRTN-së me shënime shpjeguese	31
SHTOJCA 4: Kodet e vendeve	47
SHTOJCA 5: Forma raportuese për SRTN	49

Kodet e SRTN-së

MALLRAT	31
110 Importi dhe eksporti i mallrave	31
111 Tregtimi.....	31
112 Ari jomonetar	31
SHËRBIMET	31
210 Shërbimet e prodhimit për mallrat në pronësi të tjerëve.....	31
211 Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	31
SHËRBIMET E TRANSPORTIT	32
Shërbimet e pasagjerëve.....	32
212 Transport ajror.....	32
213 Transporti detar	32
214 Transporti rrugor dhe hekurudhor	32
SHËRBIMET E MALLRAVE	32
215 Transporti ajror.....	32
216 Transporti detar	32
217 Transporti rrugor dhe hekurudhor	32
SHËRBIME TË TJERA MBËSHTETËSE DHE NDIHMËSE TË TRANSPORTIT	32

218 Transporti ajror.....	33
219 Transporti detar	33
220 Transport rrugor dhe hekurudhor	33
221 Transporti nëpërmjet tubacionit	33
222 Transmisioni i energjisë elektrike	33
223 Shërbime të transportit postar dhe shërbimet ndërlidhëse	33
SHËRBIMET E UDHËTIMIT	33
224 Udhëtimet për qëllime të biznesit.....	33
Udhëtimi për qëllime personale	33
225 Udhëtimi për qëllimet shëndetësore	33
226 Udhëtimi për qëllime arsimore	34
227 Të gjitha qëllimet e tjera.....	34
228 Ndërtimi jashtë vendit	34
229 Ndërtimi në Kosovë	34
SHËRBIME TË SIGURIMEVE DHE PENSIONIT	34
230 Sigurimi i drejtpërdrejtë	34
231 Sigurim i jetës	34
232 Sigurimi i mallrave.....	34
233 Risigurimi.....	34
234 Shërbimet ndihmëse të sigurimit	34
235 Shërbimet e pensionit dhe të garancive të standardizuara	35
SHËRBIMET FINANCIARE	35
236 Shërbimet financiare	35
TARIFAT PËR PËRDORIMIN E PRONËS INTELEKTUALE	35
237 Të drejtat pronësore.....	35
238 Licensat për përdorim, riprodhim dhe shpërndarje.....	35
239 Shërbimet e telekomunikacionit	35
SHËRBIMET KOMPJUTERIKE.....	35
240 Zhvillimi i softuerit	36
241 Shërbime të tjera kompjuterike të ndërlidhura	36
SHËRBIMET E INFORMIMIT	36
242 Shërbimet e agjencive të lajmeve	36
243 Shërbimet e tjera të informimit	36
SHËRBIMET E KONSULENCËS PROFESIONALE DHE TË MENAXHIMIT	36
245 Shërbimet ligjore.....	36
246 Përfaqësimi, dokumentimi, kontabiliteti, auditimi, libërmbajtja	36
247 Shërbime të tjera profesionale dhe zhvillimore	37
SHËRBIMET TEKNIKE, SHËRBIMET E LIDHURA ME TREGTINË DHE SHËRBIMET E TJERA TË BIZNESIT	37
248 Shërbimet arkitekturale, të inxhinierisë dhe shërbime të tjera teknike	37
249 Trajtimi dhe eliminimi i ndotjes, shërbimet bujqësore dhe të minierave	37
250 Shërbime të tjera biznesi të lidhura me tregtinë	37
251 Lizingu (qiraja) operativ.....	37
SHËRBIME PERSONALE, KULTURORE DHE TË NDËRLIDHURA	37
252 Shërbimet audio vizuale dhe të ndërlidhura	37
253 Shërbime të tjera personale, kulturore dhe rekreative	37
MALLRAT DHE SHËRBIMET QEVERTARE.....	37
254 Ambasadat dhe konsullatat.....	38
255 Njësitë dhe agjencitë ushtarake	38
256 Mallra dhe shërbime të tjera qeveritare	38

TË ARDHURAT	38
310 Dividendët dhe tërheqjet	38
311 Të ardhurat nga investimet në ekuitet dhe aksionet e fondit të investimeve	38
312 Interesi.....	38
313 Taksat dhe subvencionet në prodhim	38
314 Tatimet mbi të ardhurat dhe pasurinë	39
315 Qiraja.....	39
DËRGESAT DHE TRANSFERET TEK NPISHS	39
316 Kompensimi i punonjësve	39
317 Përfitimet sociale që lidhen me fondet e pensioneve dhe sigurimet shoqërore	39
318 Kontributet sociale në skemat e pensioneve dhe skemat e sigurimeve shoqërore.....	39
319 Transferet personale	39
320 Lotaritë dhe lojërat e tjera të fatit	39
321 Transferet përmes operatorëve të transferit të parave që nuk përfshihen më sipër.....	40
322 Fondet e dërguara nga individë për depozitim në llogarinë vetanake bankare	40
323 Primet dhe pretendimet (dëmet) e sigurimit jo-jetë (siguruesi dhe i siguruari).....	40
324 Transferime të tjera të ndryshme	40
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR AKTUAL.....	40
NDIHMJA E HUAJ ZHVILLIMORE NDËRMJET QEVERIVE.....	40
410 Transferet rrjedhëse dhe asistencë teknike	40
411 Transferet kapitale (grantet e mëdha investuese)	40
412 Transferet për institucione jofitimprurëse që u shërbejnë ekonomive familjare (NPISH)	41
413 Kontributet që u paguhen organizatave ndërkombëtare	41
414 Të tjera	41
ASETET JOFINANCIARE, TË PRODHUARA DHE JO TË PRODHUARA	41
510 Kriptoalutat (Bitcoin dhe kripto asetet e ngjashme)	41
512 Shitjet (heqjet) e aseteve jo të prodhuara jofinanciare (pranimet).....	41
513 Blerjet e aseteve jo të prodhuara jofinanciare (pagesat)	41
INVESTIMET DIREKTE	42
INVESTIMET DIREKTE JASHTË VENDIT	42
610 Blerja e pasurisë së paluajtshme jashtë vendit.....	42
611 ID-ja nga Kosova investon në ndërmarrje të investimeve direkte jashtë vendit.....	42
612 Investimet e kundërta (një NID jashtë vendit blen ekuitet në ID-në të saj në Kosovë).....	42
613 Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” (blerja e ekuitetit).....	42
INSTRUMENTET E BORXHIT (HUADHËNIA NDËRMJET KOMPANIVE)	42
614 ID-ja nga Kosova i jep hua ose kredit tregtar NID-së së tij jashtë vendit	42
615 Investimet e kundërta (ID-ja merr kredi në NID-në e tij në Kosovë).....	43
616 Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” (blerja e instrumenteve të borxhit).....	43
INVESTIMI DIREKT NË KOSOVË.....	43
EKUITETI	43
617 Investimet nga migrantët në pasuri të paluajtshme	43
618 Investimet nga të gjithë jorezidentët e tjerë në pasuri të paluajtshme në Kosovë	43
619 ID-ja jashtë vendit investon në NID-në në Kosovë	43
620 Investimet e kundërta	43
621 Ndërmjet kompanive “simotra” (blerja e ekuitetit)	43
INSTRUMENTET E BORXHIT	44

622 DI-ja jashtë vendit ofron një kredi ose kredi tregtare për DIE-në e saj në Kosovë	44
623 Investimet e kundërta (ID-ja merr kredi nga DIE-ja e saj jashtë vendit)	44
624 Midis ndërmarrjeve “simotra” (blerja e instrumenteve të borxhit).....	44
INVESTIMET PORTOFOLI	44
710 Aksionet e listuara të ekuitetit	44
711 Aksionet e palistuara të ekuitetit (ekuiteti privat/kapitali sipërmarrës).....	44
712 Aksionet e fondit të investimeve	44
713 Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë (më shumë se një vit)	44
714 Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër (1 vit ose më pak)	45
DERIVATIVËT FINANCIAR.....	45
810 Kontratat paraprake (ang. forwards).....	45
812 Opsionet, kontratat e së ardhmes (ang. futures), garancitë, shkëmbimet, etj.....	45
INVESTIMET E TJERA	45
910 Ekuiteti tjetër që nuk është pjesë e ID-ve dhe IP-së	45
911 Depozitat	45
912 Huat afatgjata	45
913 Huat afatshkurtra	45
914 Llogaritë e tjera të arkëtueshme/të pagueshme.....	45
ASETET E RESERVËS.....	46
101 Ari monetar	46
102 Të drejtat speciale të tërheqjes/tirazhit (SDR).....	46
103 Pozicioni i rezervës në FMN	46
104 Depozitat	46
105 Letrat me vlerë	46
106 Pretendimet tjera	46

PARATHËNIE

Përpilimi i statistikave të bilancit të pagesave të Kosovës të cilat janë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të besueshme është thelbësor në formulimin e politikave nga autoritetet kosovare, me qëllim që të vendosen themele të shëndosha për një zhvillim të qëndrueshëm. Publikimi i statistikave të prodhuara me cilësi të lartë ofron informacione të vlefshme për sektorin privat, investitorët e huaj, agjencitë e vlerësimit si dhe publikun e gjerë në përgjithësi. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) që nga fillimi i saj ka punuar në zhvillimin e një sistemi efikas për mbledhjen e të dhënave dhe publikimin e statistikave për ekonominë e Kosovës. Statistikat e bilancit të pagesave përpilohen nga BQK prej vitit 2004, kurse një nga burimet kryesore të informatave është raporti i pagesave të jashtme nga bankat vendore, i quajtur Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN). Ky raport është implementuar për herë të parë nga BQK dhe bankat komerciale në vitin 2005 dhe është avancuar edhe dy herë të tjera.

Kam kënaqësinë të prezantojë edicionin e katërt të Udhëzimeve për Raportim të SRTN-së, i cili adreson zhvillimet e shumta të rëndësishme që kanë ndodhur në ekonominë ndërkombëtare që nga botimi i edicionit të tretë. Këto Udhëzime për Raportim janë përgatitur nga Departamenti i Statistikës bazuar në standardet ndërkombëtare të rekomanduara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Eurostati. Konceptet e përshkruara në këto udhëzime të SRTN-së janë në harmoni me Manualin e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, botimi i gjashtë (2009) si dhe dokumenti shoqërues i këtij manuali, Udhëzuesin e BPM6. Prandaj, informata më të zgjeruara për pagesat e jashtme janë të gatshme në këto dy botime të FMN-së. Drafti i udhëzimeve për raportim është diskutuar me bankat komerciale për komente. Dua të falënderoj të gjithë përfaqësuesit e bankave të përfshirë për ndihmën e çmueshme dhe për frymën e tyre bashkëpunuese.

Udhëzimet për Raportim të SRTN-së kanë për qëllim t'iu shërbejnë raportuesve dhe përdoruesve të statistikave të bilancit të pagesave, duke ofruar udhëzime për mbledhje të informatave për raportim. Këto udhëzime për raportim përfshijnë edhe format raportuese, raportimi i të cilave është i obligueshëm për të gjitha bankat komerciale të licencuara nga BQK. Ky aspekt juridik është i rregulluar me Ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-209, dhe specifikuar më konkretisht me Rregulloren për statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare miratuar nga Bordi i BQK-së në mbledhjen e mbajtur më 26 dhjetor 2013.

I ftoj bankat komerciale që operojnë në Kosovë të respektojnë kërkesat raportuese që barten në dokumentin në vazhdim “*Udhëzimet për Raportim të SRTN-së — versioni 4*” dhe të fillojnë raportimin në përputhje me këto udhëzimeve nga muaji mars 2020. BQK do të publikojë Udhëzimet për Raportim të SRTN-së në faqen e internetit të BQK-së me shpresë se do t'i ndihmojë bankat në përpjekjet e tyre për të siguruar informatat e nevojshme me cilësi të lartë nga klientët e tyre.

Lulzim Ismajli

Zëvendësguvernator për Operacione Bankare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

1. HYRJE

1.1 Qëllimi i SRTN

1. Udhëzuesi për Raportim i Sistemit të Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare është një dokument, i cili ofron udhëzime të qarta në lidhje me regjistrimin e transaksioneve të kryera nga bankat komerciale në Kosovë dhe të cilat raportohen në BQK. Ky version i manualit është në përputhje me rekomandimet e ofruara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) përmes *Manualit të tyre të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, botimi i 6-të* (BPM6), si dhe shembuj të praktikës më të mirë nga vende të tjera.

2. Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN) është një kornizë institucionale për mbledhjen e informacionit në lidhje me transaksionet ndërkombëtare. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave është përpilimi i Bilancit të Pagesave (BP) të Kosovës. BP është një pasqyrë statistikore që përmbledhë në mënyrë sistematike transaksionet ekonomike të një vendi me vendet e tjera të botës gjatë një periudhe të caktuar. BP përfshin një sërë kategorish, duke përfshirë mallrat dhe shërbimet, të ardhurat parësore, të ardhurat dytësore, llogarinë kapitale dhe llogarinë financiare. Statistikat e BP publikohen në baza mujore në faqen e internetit të BQK-së.

1.2 Baza ligjore

3. SRTN është zhvilluar në përputhje me ligjin e Kosovës nr. 03/L-074 "Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës". Më konkretisht, neni 6 i *Rregullores së Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare detyron bankat komerciale në Kosovë që të raportojnë SRTN-në pranë Departamentit të Statistikave të BQK-së*. Sipas kësaj baze ligjore, të gjithë personat fizikë dhe juridikë të përzgjedhur nga BQK-ja janë të detyruar të ofrojnë informacionin e kërkuar nga BQK-ja për nevoja statistikore. Raportuesit janë të detyruar të ofrojnë informacionin e kërkuar nga BQK-ja për përpilimin e statistikave të BP për Kosovën. Për më tepër, i njëjti nen specifikon lloje të ndryshme të raporteve statistikore që duhet të dorëzohen në BQK.

1.3 Konfidencialiteti

4. BQK-ja siguron raportuesit për mbrojtjen e plotë të informacionit të tyre të raportuar përmes SRTN-së, përfshirë mbrojtjen organizative, fizike, si dhe teknologjike të të dhënave. Ky informacion përdoret vetëm për përpilimin e statistikave të BP në Kosovë dhe të publikuara vetëm në formë agregate, pa identifikuar karakteristikat e bankave ose të klientëve të tyre. Të dhënat individuale të mbledhura nuk do t'i kalohen asnjë pale tjetër, përfshirë autoritetet tatimore.

2. PËRKUFIZIMET

5. Metodologjia dhe konceptet e përshkruara në këtë udhëzim për raportim janë në përputhje me BPM6¹. Kjo konsistencë është në një lidhje të ngushtë me sisteme të tjera statistikore makroekonomike, duke përfshirë Sistemin e Llogarive Kombëtare 2008 (SLLK 2008).

6. **Rezidentët** janë *persona juridikë* të regjistruar dhe që operojnë në Kosovë (përveç zyrave ndërlidhëse ndërkombëtare dhe të huaja të vendosura në Kosovë, përfshirë KFOR-in, UNMIK-un dhe EULEX-in); dhe *individët*, vendbanimi i të cilëve ndodhet në Kosovë dhe që nuk largohen nga Kosova për një periudhë më të gjatë se një vit (përveç stafit diplomatik, studentëve dhe pacientëve mjekësorë).

7. **Rezidenca e njësive institucionale** përcaktohet në bazë të një lidhjeje të fortë të njësisë me vendin operues, të shprehur si qendra e interesit ekonomik dominues. Në Kosovë, ekzistojnë dy lloje kryesore të njësive institucionale:

- a. Ekonomitë familjare - individë, ose grupe njerëzish dhe
- b. Korporatat, organizatat jofitimprurëse, si dhe njësitë qeveritare

8. **Një njësi institucionale** konsiderohet si rezident në Kosovë nëse posedon një shtëpi/apartament, një lokacion të përdorur për prodhim, ose një ndërtesë tjetër brenda territorit të Kosovës në/nga e cila njësia është e angazhuar në aktivitetet ekonomike dhe transaksione të një shkalle më të madhe për një periudhë kohore të caktuar ose të pacaktuar, por të gjatë. Vendndodhja faktike ose e synuar për një vit ose më shumë përdoret si një përkufizim operacional; megjithëse zgjedhja e një viti si një periudhë specifike është disi arbitrare, ajo është miratuar për të shmangur pasigurinë dhe për të

¹ Manuali BPM6 mund të shkarkohet nga ky link :<https://www.imf.org/external/pubs/ft/bop/2007/pdf/bpm6.pdf>

lehtësuar konsistencën ndërkombëtare. Vendbanimi (rezidenca) i familjes specifikohet bazuar në qendrën e interesit ekonomik dominues të anëtarëve të saj. Gjithashtu, vendbanimi i individëve specifikohet nga ekonomia familjare të cilës i përketin, dhe jo nga vendi i punës. Përjashtim nga ky rregull bëjnë stafi diplomatik, studentët dhe pacientët mjekësorë - të cilët mund të qëndrojnë për një vit ose më gjatë në vendet e tjera duke mos e ndryshuar vendbanimin/shtetësinë. Të gjithë anëtarët e një familje kanë të njëjtin vendbanim. Çdo njësi institucionale konsiderohet banor (rezident) i një dhe vetëm një territori ekonomik, të përcaktuar nga qendra e saj e interesit ekonomik dominues. Korporatat dhe institucionet jofitimprurëse priten të kenë një qendër të interesit ekonomik në ekonominë ku ata janë të regjistruar dhe themeluar ligjërisht.

9. **Jo rezidentët** janë *persona juridikë* të regjistruar jashtë vendit ose *persona juridikë*, banimi i përhershëm i të cilëve është jashtë territorit të Kosovës (si udhëzim mund të përdoret rregullisht një vit ose më shumë, por jo si rregull i pandryshuar: p.sh. stafi diplomatik, studentët dhe pacientët mjekësorë mbeten banorë të Kosovës, megjithëse kohëzgjatja e qëndrimit të tyre jashtë vendit është një vit ose më shumë). Degët dhe filialet e ndërmarrjeve kosovare jashtë vendit janë jo rezidentë. Zyrat ndërlidhëse të huaja dhe përfaqësuesit e vendosur në Kosovë nuk janë rezidentë, si dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, përfshirë KFOR-in, UNMIK-un dhe EULEX-in. Diplomatët, personeli ushtarak dhe punonjësit e tjerë të huaj në organizata të tilla, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët jetojnë në Kosovë dhe gëzojnë imunitet dhe privilegje diplomatike nuk janë banorë të Kosovës.

10. **Udhëtarët** konsiderohen individët që qëndrojnë jashtë vendit për më pak se një vit. Duke përfshirë individët (a) që udhëtojnë për të punuar në një bazë ushtarake, ambasadë ose agjenci të tjera qeveritare; (b) të cilët shoqërojnë ose mbeten të jenë direkt nën varësinë e individëve në kategorinë e përmendur në pikën (a); dhe (c) ata që udhëtojnë për t'u përfshirë direkt në ndonjë veprimtari prodhuese për një kompani që është rezidente jashtë ekonomisë së vendit. Periudha njëvjeçare nuk vlen për studentët dhe pacientët që marrin shërbime të kujdesit shëndetësor, kështu që të gjitha kostot e tyre, përfshirë ato për arsim dhe kujdes shëndetësor, duhet të regjistrohen nën zërin '*shpenzimet e udhëtimit*'.

11. **Një transaksion** përfshin një bashkëveprim midis dy njësisë institucionale, të arritur përmes një marrëveshjeje të ndërsjellë ose përmes ligjit dhe përfshin një transfer ose shkëmbim vlere. Transaksionet e regjistruara në bilancin e pagesave përfshijnë transaksionet midis njësisë institucionale rezidente dhe jo rezidente. Për të specifikuar nëse një transaksion duhet të raportohet në BQK përmes SRTN, përpiluesi duhet të jetë i vetëdijshëm për identitetin e të dy palëve të përfshirë në transaksion (pala rezidente dhe jo rezidente). Transaksionet e jashtme mund të jenë të veçanta ose të lidhura.

12. **Një transaksion i veçantë** përfshin pagesa të realizuara vetëm për një qëllim, dhe kështu, për klasifikimin e tyre zbatohet vetëm një kod, në përputhje me shtojcën 2. Kjo nënkupton se nuk do të ketë netim ose rregullime të mëtejshme (ripagesë ndaj palës tjetër të përfshirë në transaksion). Për shembull, pagesa për importin e mallrave përbën një transaksion të veçantë (të zbatuar me kodin 110), pasi kryhet vetëm për një qëllim: importin e mallrave.

13. **Një transaksion i përbërë** përfshin pagesa të realizuara për qëllime të shumëfishta dhe kështu, aplikohet më shumë se një kod. Për shembull, shlyerja e kredive mund të përfshijë 1) pagesën e shumës së kryegjësë, 2) pagesën e interesit dhe 3) tarifën për transferin bankar. Ky lloj transaksioni përbën një transaksion të përbërë. Në këtë rast, kodi 912 aplikohet për pagesën e shumës së kryegjësë, ndërsa kodi 312 aplikohet për pagesën e interesit. Nëse një pagesë jashtë vendit përfshin elemente, qëllimi i të cilave ndryshon, atëherë secili element do të trajtohet/regjistrohet si një pagesë e veçantë jashtë vendit.

14. **Një investitor direkt jo rezident (ID)** është një entitet jo rezident (ose një grup i përbashkët i jo rezidentëve), i cili posedon 10% ose më shumë të aksioneve në një kompani të huaj. Një kompani mund të ketë më shumë se një investitor direkt dhe ata mund të jenë nga vende të ndryshme. Të qenit i konsideruar investitor direkt nuk kërkon të poseduarit e pjesës më të madhe të pronësisë. Një investitor direkt mund të jetë një individ, një ndërmarrje private ose publike, një grup i lidhur individësh ose ndërmarrjesh, qeveria ose agjenci qeveritare; ose një organizatë tjetër që ka në pronësi ndërmarrjen nga investimi direkt, në një ekonomi tjetër nga ajo ku konsiderohet rezident.

15. Ndërmarrja e Investimeve Direkte (NDI) përfshin një ndërmarrje të themeluar në një ekonomi dhe e cila përfshin një investitor jo rezident që zotëron, direkt ose indirekt, 10% të autoritetit të votimit. NDI mund të jetë si në vijim:

- Ndërmarrjet bashkëpronare (të asociuara), në të cilat një investitor rezident zotëron ndërmjet 10 dhe 50% të aksioneve;
- Ndërmarrjet vartëse, në të cilat një investitor direkt zotëron më shumë se 50% të aksioneve;
- Degët-ndërmarrjet në të cilat një investitor direkt zotëron 100% të aksioneve.

16. **Ndërmarrjet "simotra" (që kanë një kompani amë të përbashkët) (ang. fellow enterprises)** përfshijnë kompanitë të cilat janë rezidente në vende të tjera, kanë një marrëdhënie investimesh direkte me njëra-tjetrën (p.sh. kanë një investitor të përbashkët direkt/indirekt), por asnjë prej këtyre kompanive nuk është investitor direkt në një kompani tjetër.

17. **Korporatat e tjera deponituese** (këtu e tutje "Bankat") janë korporata financiare rezidente dhe kuazi-korporata, përfshirë bankat komerciale dhe përjashtuar BQK-në, aktiviteti kryesor i të cilave është ndërmjetësimi financiar. **Klienti i bankës** mund të jetë një kompani jofinanciare, bankë, institucion jofitimprurës që u shërben ekonomive familjare (NPISH), njësi qeveritare, përfshirë fondet e sigurimeve shoqërore dhe pensionale, individë, etj.
18. **Ndërmarrja** është një njësi institucionale me kapacitetin për të prodhuar mallra ose shërbime. Një ndërmarrje mund të jetë një korporatë, kuazi-korporatë, ose një ndërmarrje jo e inkuorpuar.
19. **Autoriteti Monetar** është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).
20. **Qeveria e përgjithshme** përbëhet nga të gjitha institucionet qeveritare (Parlamenti, Ministrinë dhe departamentet e tyre, Gjykatat, Komunat, etj.).
21. **ID e bankës** tregon numrin e identifikimit të bankës. Shënjuar me një kod numerik 2-shifror, i caktuar në përputhje me rregullat dhe rregulloret e BQK-së.
22. **Data e transaksionit** është data në të cilën kryhet transaksioni, p.sh. data kur llogaria e një klienti debitohet ose kreditohet.
23. **Klientë rezidentë** janë personat juridikë të regjistruar dhe që operojnë në Kosovë, si dhe *individët*, rezidenca e të cilëve është e vendosur në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për një periudhë më të gjatë se një vit (referojuni faqes 9, paragrafi 6 për një përkufizim më të hollësishëm).
24. **Numri i regjistrimit** është një kod alfa numerik që kërkohet për klientët rezidentë. Kodi specifikohet si më poshtë:
- Numri unik i identifikimit** është një kod alfa numerik i zbatueshëm për subjektet afariste dhe institucionet financiare dhe kërkohet nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
 - Numri i regjistrimit për organizatat joqeveritare** është një kod alfa numerik i cili gjithmonë fillon me 5, është i zbatueshëm për OJQ-të dhe caktohet nga Departamenti i Shërbimeve të Regjistrimit në Ministrinë e Administratës Publike.
 - Kodi i identifikimit** është një kod, i cili gjithmonë fillon me 9, është i zbatueshëm për institucionet qeveritare (qendrore ose lokale), dhe përcaktohet nga Administrata Tatimore e Kosovës. Nëse një kod i plotë nuk është në dispozicion, ai duhet të raportohet si kod identifikimi "90000000".
 - Kodi i identifikimit për individë** përcaktohet gjithmonë me "10000000".
25. **Klientë jo rezidentë** janë persona juridikë të regjistruar jashtë vendit ose persona juridikë, rezidenca e përhershme e të cilëve është jashtë territorit të Kosovës (shih faqe 7, paragrafi 9 për një përshkrim të hollësishëm).
26. **Kodi i valutës së huaj** është kodi i valutës Alfa, një kod 3-shifror në përputhje me Shtojcën 3 (Kodet e vendeve dhe valutave), i cili bazohet në ISO 4217 në lidhje me emrat e valutave dhe elementet e kodit.²
27. **Kodi i vendit** është një kod 2-shifror në përputhje me Shtojcën 3 (Kodet e vendeve dhe valutave), dhe bazohet në ISO 3166 në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare.³
28. **Palët e tjera në transaksion** (palët) janë klientët jo rezidentë.
29. **Kodi i palës së kundërt** është një kod i kombinuar i palës tjetër në transaksion, dhe përcaktohet si më poshtë:

Kodi	Emri
10.	Rezident;
20.	Jo rezident, përveç UNMIK-ut, EULEX-it ose KFOR-it;
22.	UNMIK (Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë);
23.	EULEX (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë);
24.	KFOR.

² Organizata Ndërkombëtare për Standarde (http://www.iso.org/iso/support/currency_codes_list-1.htm).

³ Organizata Ndërkombëtare për Standarde (http://www.iso.org/iso/english_country_names_and_code_elements).

30. **Kodi SRTN** është një kod numerik 3-shifror i cili mundëson përcaktimin e fushës së pagesës së huaj dhe tregon indikacionin kryesor të nevojshëm për zhvillimin e BP. Për më shumë informacion mbi kodin SRTN, shikoni Shtojcën 2 (kodet SRTN) dhe Shtojcën 3.

31. **Përshkrimi i transaksionit** është një përshkrim i llojit të mallrave ose shërbimeve, transfereve ose transaksioneve në formë të pretendimeve ose detyrimeve financiare dhe të cilat mund të jenë pagesa jashtë apo pranime . Përshkrimi i transaksionit është jetik për kategorizimin e duhur të transaksioneve në Bilancin e Pagesave të një vendi.

3. KËRKESAT DHE AFATET KOHORE TË RAPORTIMIT

3.1 Kërkesat për bankat

32. Bankat në Kosovë duhet të zhvillojnë dhe raportojnë tek BQK të dhënat mbi transaksionet hyrëse dhe dalëse të vetë (1) bankës dhe (2) klientëve të bankës. Raportimi duhet të bëhet në përputhje me këto udhëzime. Raporti i SRTN përmban format e mëposhtme:

Formulari 1	Transaksionet e vetë bankave;
Formulari 2	Transaksionet e klientëve të bankave në vlerë më të madhe ose të barabartë me 10,000 Euro;
Formulari 4	Transaksionet e klientëve të bankave në vlerë më të vogël se 10,000 Euro;
Formulari 5	Transaksionet e klientëve të bankës me kartela bankare

33. Mbledhja e të dhënave kryhet së pari nga klienti i bankës dhe/ose stafi i bankës bazuar në informacionin/dokumentet e ofruara nga klienti, përmes një urdhër pagese (për më shumë detaje, shih Urdhërpagesën e Bankës, faqe 12). Formularët e plotësuar të raportit do t'i dorëzohen BQK-së.

34. Raporti i SRTN duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike, në përputhje me format e specifikuar. Versioni elektronik duhet të përfshijë të gjitha format e specifikuar. Raporti duhet të dërgohet nga persona të autorizuar të bankës raportuese. Raportimi elektronik nënkupton se raporti është nënshkruar dhe vulosur nga persona të autorizuar nga banka raportuese.

3.2 Kërkesat për klientët

35. Për të siguruar raportimin nga klientët e bankës në lidhje me pagesat e jashtme, informacionet e nevojshme për qëllime të SRTN përfshijnë si në vijim:

Urdhri i transaksionit:

- Emri i palës rezidente të përfshirë në transaksion.
- Numri i regjistrimit të palës rezidente të përfshirë në transaksion
- Emri i palës jo rezidente të përfshirë në transaksion
- Kodi i vendit i palës jo rezidente të përfshirë në transaksion
- Kodi i transaksionit
- Përshkrimi i transaksionit, dhe
- Shuma e transaksionit

36. Për transaksionet hyrëse, bankat duhet të marrin informacionin e nevojshëm nga klientët e bankave, të cilët përbëjnë përfituesin në transaksionin që raportohet në BQK. Nëse informacioni i mbledhur nuk është i plotë për SRTN, banka duhet të kontaktojë klientin për të ofruar shpjegime shtesë në lidhje me transaksionin.

3.3 Afatet kohore të regjistrimit dhe raportimit në BQK

37. Raporti i SRTN duhet të dorëzohet në BQK nga bankat komerciale në baza mujore jo më vonë se i 15-ti i muajit pasues të periudhës referuese.

38. Transaksionet duhet të raportohen në mënyrë individuale, dhe jo të agreguara. Kjo nënkupton që çdo pagesë duhet të raportohet si një transaksion i veçantë në Raportin e SRTN që do të dorëzohet nga bankat komerciale në BQK.

39. Në rast mospërputhjes të vërejtura nga stafi i BQK-së në të dhënat e raportuara, banka komerciale duhet të ofrojë informacionin e domosdoshëm shtesë të kërkuar. Pyetjet në lidhje me udhëzimet e raportimit të SRTN, përfshirë interpretimin dhe sqarimet shtesë duhet t'i adresohen Departamentit të Statistikave në BQK. Informacioni shtesë i kërkuar duhet t'i dërgohet BQK-së jo më vonë se 5 ditë pune pasi të bëhet kërkesa nga stafi i BQK-së.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË BANKËS (Formulari 1)

3.4 Formulari i transaksioneve të vetë bankës

40. Formulari 1 mbledh të dhëna për transaksionet bankare nga jo rezidentët. Çdo transaksion duhet të raportohet si një regjistrim/hyrje e veçantë. Transaksionet bankare në mallra, shërbime, transferime, investime direkte dhe letra me vlerë duhet të raportohen në Formularin 1 si regjistrime/shënime specifike. Transaksionet në investime të tjera (d.m.th. investimet në depozita jashtë vendit ose huazimi nga jashtë) do të raportohen si diferenca midis gjendjes fillestare dhe asaj përfundimtare të periudhës së raportimit. Në mungesë të hapësirës në formular, mund të shtohen linja shtesë. Është e rëndësishme të bashkëngjitni informacion shtesë nëse është e nevojshme në mënyrë që përshkrimi i transaksionit të jetë i qartë.

Data/periudha e raportimit për transaksionet nën pjesët A deri në F duhet të futet në formatin dd/mm/vvvv (p.sh. 31/01/2020), ndërsa transaksionet nën pjesët G deri në H do të shkruhen në formatin mmm/vvvv (p.sh. janar/2020);

Numër serik është një kod 3-shifror i lidhur me transaksionin. Numri 001 duhet të jetë numri i parë, dhe ky numër rritet me 1 për secilin transaksion pasues;

Kodi SRTN paraqet kodimin e nevojshëm për përpilimin e statistikave të BP bazuar në Shtojcën 2 (kodet SRTN). Nëse një bankë nuk mund të gjejë kodin përkatës SRTN, personeli përgjegjës i bankës duhet të kontaktojë Departamentin e Statistikave për ndihmë, ose të shënjojë kodin 999. Në raste të tilla, një përshkrim i hollësishëm jepet nën "Përshkrimi i transaksionit";

Përshkrimi i transaksionit duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm në mënyrë që kodi i transaksionit të mund të verifikohet;

Pagesat përfaqësojnë vlerën e transaksioneve dalëse, p.sh. pagesa për importin e mallrave, për import të shërbimeve, pagesa të interesit, dividendë, etj. ;

Pranimet përfaqësojnë vlerën e transaksioneve hyrëse, p.sh. pranimet për eksport të mallrave, eksportet e shërbimeve, pranimet në emër të interesit, dividendëve, etj.;

Kodi i kundër palës (palës homologe) është një kod i kombinuar i palës tjetër në transaksionin e përcaktuar në paragrafin 29.

Kodi i vendit është shkurtesa e emrit të Vendit në përputhje me Shtojcën 4.

Formulari 1 – Transaksionet vetanake të bankës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës										
Formular 1- Transaksionet vetanake të bankës										
Numri	Data e transaksionit	Numri i referencës	Emri i jo-rezidentit	Kodi ISIN	Kodi i vendit	Kodi i SRTN	Kodi i brendshëm SRTN	Përshkrimi i transaksionit	Pagesat	Pranimet

TRANSAKSIONET E KLIENTËVE TË BANKËS

(Formulari 2 dhe Formulari 3)

3.1. Kërkesat e raportimit

Transaksionet e klientëve të bankave raportohen në dy formularë: Formulari 2 $\geq 10,000$ dhe Formulari 3 $< 10,000$. I pari përpilon në mënyrë sistematike informacionin mbi transaksionet e klientëve të bankës në vlerë prej 10,000 euro ose më shumë, ndërsa i dyti përfshin transaksione në vlerë më të vogël se 10,000 euro. Transaksionet në valutat jo-euro do të shndërrohen në valuta euro me kursin që aplikohet në datën e transaksionit. Në formularin elektronik, në mungesë të hapësirës, mund të shtohen linja shtesë. Pas udhëzimeve për plotësimin e formularit, formularët shabllon janë dhënë si udhëzim.

3.2. Udhëzimet për plotësimin e formularit

Numri serik është një kod 4-shifror i lidhur me transaksionin. Numri 0001 duhet të jetë numri i parë, dhe ky numër rritet me 1 për secilin transaksion pasues;

Data e transaksionit është një numër 4-shifror dhe duhet të shkruhet në formatin dd/mm/vv;

Numri i referencës si numri i referencës së transaksionit të përdorur nga banka;

Kodi bankar është e njëjtë me ID të Bankës;

Emri i klientit rezident përfaqëson emrin e një klienti rezident të Kosovës, i cili mund të jetë urdhërues ose marrës;

Numri i regjistrimit është një kod për të identifikuar klientin rezident. Për më shumë shikoni përkufizimin e "numrit të regjistrimit" në "Kushtet dhe përkufizimet";

Emri i klientit jo rezident përfaqëson emrin e klientit jashtë vendit, i cili mund të jetë urdhërues ose marrës;

Kodi i palës së kundërt (palës homologe) është një kod i kombinuar i palës tjetër në transaksion siç përcaktohet në paragrafin 25.

Kodi i vendit është shkurtesa e emrit të Vëndit në përputhje me Shtojcën 4;

Kodi SRTN duhet të jetë në përputhje me Shtojcën 2. Ky Kod përcaktohet nga banka për transaksione prej 10,000 eurosh ose më shumë. Për transaksione në vlerë më të vogël se 10,000 euro, kodi SRTN përcaktohet nga BQK-ja;

Kodi i brendshëm i SRTN përcaktohet nga stafi i BQK-së dhe përdoret për të identifikuar gabimet më të mundshme që shpesh përsëriten gjatë raportimit;

Përshkrimi i transaksionit në rastin e transaksioneve në vlerë prej 10,000 eurosh ose më shumë. Përshkrimi do të jetë i detajuar dhe i tillë që kodi i transaksionit të mund të verifikohet. Për transaksione në vlerë më të vogël se 10,000 euro, jepet një përshkrim i përgjithshëm ashtu siç është regjistruar në Urdhërpagesë me rastin e inicimit të transaksionit;

Pagesat përfaqësojnë vlerën e transaksioneve dalëse, p.sh. pagesa për importin e mallrave, për importin e shërbimeve, pagesa të interesit, dividendë, etj.;

Pranimet përfaqësojnë vlerën e transaksioneve hyrëse, p.sh. pranimet për eksport të mallrave, eksportet e shërbimeve, pranimet në emër të interesit, dividendëve, etj .;

Formulari 2 dhe 3 - Transaksionet e klientëve të bankës (≥10,000 euro dhe <10,000 euro)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës													
Formulari 2 dhe 3 - Transaksionet e klientëve të bankës (≥10,000 euro dhe <10,000 euro)													
Numri	Data e transaksionit	Numri i referencës	Kodi i bankës	Emri i rezidentit	Numri i regjistrimit	Emri i jo-rezidentit	Kodi i palës tjetër	Kodi i shtetit	Kodi i SRTN	Kodi i brendshëm i SRTN	Përshkrimi i transaksionit	Pagesat	Pranimet

4. TRANSAKSIONET E KLIENTËVE TË BANKAVE ME KARTELA BANKARE (Formulari 4)

4.1. Kërkesat e raportimit

Transaksionet e klientëve të bankave të bëra me kartela debiti dhe krediti raportohen në Formularin 4. Për dallim nga formularët e mëparshëm, Formulari 4 përmban pagesa dhe tërheqje të raportuara të bëra nga klientët nëpërmjet përdorimit të kartelave bankare. Transaksionet në valuta jo-euro do të konvertohen në valutën euro bazuar në kursin valutor që aplikohet në datën e transaksionit. Në mungesë të hapësirës në formular, mund të shtohen rreshta shtesë. Pagesat përfshijnë shumën e pagesave/tërheqjeve nëpërmjet përdorimit të kartelave bankare kosovare jashtë vendit, ndërsa pranimet përfshijnë shumën e pagesave/tërheqjeve nga individët nëpërmjet përdorimit të kartelave të huaja bankare në Kosovë. Pas udhëzimeve në lidhje me plotësimin e formularit, jepen formularët udhëzues për udhëzim.

4.2. Udhëzimet për plotësimin e formularit

Numri serik është një kod 4-shifror i lidhur me transaksionin. Numri 0001 duhet të jetë numri i parë, dhe ky numër rritet me 1 për secilin transaksion pasues;

Data e transaksionit duhet të shkruhet në formatin dd/mm/vv;

Kodi bankar është i njëjtë me ID të Bankës;

Emri i klientit përfaqëson emrin e klientit, i cili përdor një kartelë debiti ose krediti;

Vendbanimi është i shënuar me një kod vendbanimi (rezidence) për klientët e bankave të Kosovës. Rezidentët duhet të shënohen me kodin 1 dhe jo rezidentët që posedojnë kartela bankare të Kosovës duhet të shënohen me kodin 2;

Lloji i transaksionit duhet të shënohet si "tërheqje" kur kartela përdoret për të tërhequr para nga një bankomat (ATM) dhe duhet të shënohet si "pagesë" (i lirë) atëherë kur bëhet pagesa.

Kodi i vendit do të jetë një kod dyshifror në përputhje me Shtojcën 4;

Emri i vendit do të jetë gjithashtu në përputhje me Shtojcën 4;

Pranimet përfaqësojnë shumën e pagesave/tërheqjeve në Kosovë nga klientët që përdorin kartelat e huaja bankare.

Formulari 4 - Transaksionet e klientëve të bankës me kartela bankare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës											
Formulari 4 – Transaksionet e klientëve të bankës me kartela bankare											
Numri	Data e transaksionit	Kodi i bankës	Emri i rezidentit	Rezidenca	Lloji i transaksionit	Kodi i shtetit	Emri i shtetit	ID e terminalit	Lokacioni	Pagesa	Pranime

Shtojca 1: MODEL I URDHËRPAGESËS PËR BANKAT KOMERCIALE

Çdo individ, kompani ose autoritet publik në Kosovë mund të kryejë ose të pranojë pagesa nga jo rezidentët pa kufizime ose autorizim zyrtar. Sidoqoftë, për këto pagesa të jashtme të bëra ose të pranuar nga jo rezidentët, zbatohen rregulla të caktuara përkritazi me qëllimet statistikore. Statistikat e mbledhura nga BQK-ja për përpilimin e bilancit të pagesave të Kosovës rregullohen me ligj. Prandaj, ekziston një detyrim ligjor sipas të cilit klientët duhet të japin një informacion të tillë. BQK garanton konfidencialitet të plotë për të dhënat e siguruar nga këta formularë. Të dhënat individuale të mbledhura nuk do të kalojnë tek palët tjera dhe ato do të paraqiten të agreguara dhe pa karakteristika të identifikueshme.

Pagesat e huaja dalëse që duhet të raportohen përfshijnë pagesa të bëra nga banka nga rezidentët e Kosovës për jo rezidentët, ose rezidentët jashtë vendit (përfshirë transferet në llogarinë vetanake të pagesit në një bankë jo rezidente); dhe pagesat e bëra nga rezidentët ndaj jorezidentëve në Kosovë, përfshirë KFOR-in, UNMIK-un, EULEX-in, etj.

Transaksionet që nuk kërkohet të raportohen janë pagesa midis jo rezidentëve dhe pagesat ndërmjet rezidentëve brenda Kosovës.

Përgjigjet ndaj pyetjeve të Urdhërpagesës duhet të shkruhen qartë dhe rekomandohet që një kopje të ruhet nga personi ose kompania që e plotëson atë.

Shablioni i mëposhtëm përmban fushat e detyrueshme për çdo urdhërpagesë të aplikuar nga bankat komerciale në Kosovë. Bankat mund të kenë formularë të ndryshëm të urdhërpagesës, por të gjithë këta formularë duhet të përmbajnë fushat e mëposhtme:

1. Data e transaksionit
2. Numri i referencës
3. Emri i klientit rezident
4. Numri i regjistrimit të klientit rezident
5. Emri i klientit jo rezident
6. Kodi i klientit jo rezident
7. Kodi i vendit
8. Kodi SRTN
9. Përshkrimi i transaksionit
10. Vlera

Këto fusha janë inkorporuar në modelin (shabllonin) e urdhërpagesës të paraqitur më poshtë.

INTERNATIONAL PAYMENT ORDER / URDHËR PAGESË NDËRKOMBËTARE

Logo e bankës

20: Ref.:
Form No:

Numri i referencës

50: Ordering Customer Details / Të dhënat mbi Urdhëruesin

 Resident Non Resident

Account No.: Nr. i llogarisë:	ID No. or Registration No.: Nr. i ID-së ose Regjistrimit të Firmës
Name: Emri:	Tel: Shteti:
Address: Adresa:	Country: Shteti: Kosove

Klienti urdhërues,
zakonisht klienti rezident.

Numri i regjistrimit për klientin rezident

59: Beneficiary Details / Të dhënat mbi Përfituesin

Account No.: Nr. i llogarisë:	Country: Shteti:
Name: Emri:	
Address: Adresa:	

Klienti përfitues, zakonisht klienti jo rezident

56: Intermediary Bank Details / Të dhënat mbi Bankën ndërmjetësuese

SWIFT Code: Kodi SWIFT:	Kodi i bankës:
Name: Emri:	

57: Beneficiary's Account with Institution details / Të dhënat mbi Llogarinë e Bankës së Përfituesit

SWIFT Code: Kodi SWIFT:	Kodi i bankës
Name: Emri:	
Address/Adresa	Country: Shteti:

32A: Transfer Amount / Shuma e transferimit

Currency: Valuta:	Amount Shuma:	Exchange Rate/ Kursi i këmbimit:
Amount in words: Shuma me fjalë:		

70: Payment Details / Të dhënat mbi pagesën

71A: Charges / Tarifat

Third Party Charges/Tarifat e palëve të treta	OUR/Urdhëruesi	SHA/Përbashkët	BEN/Përfituesi
Bank Charge/Tarifa e Bankës _____ % () min	Total Amount/ Gjithsejt Vlera: _____		

Client declaration if payment is based on document:

Documents presented: Dokumentet e prezantuara:	Document References/ Referencat e dokumentit	Amount/ Shuma	Date/ Data

There are No Documents: Kodi i klientit jo rezident.

Other party's country code/ Kodi i palës tjetër: Shteti.

UNMIK/EULEX KFOR

Nuk ka Dokument: Resident Non-resident

Please complete this form for payments of 10,000.00 Euros or more, or equivalent in other currencies. Ju lutemi të plotësoni tabelën më poshtë për pagesat 10,000.00 euro e më shumë, apo ekuivalente në valutat tjera.

Transaction Code/Kodi i Transaksionit	Description of the transaction / Përshkrimi i Transaksionit	Amount/Shuma (Fill out, if amount is split / Të plotësohet nëse shuma është ndaras)
Kodi SRTN.	Përshkrimi i transaksionit	Vlera
Additional details on underlying nature of the transaction, including further amounts if applicable lidhje me llojin e transaksionit, shumat tjera nëse ekzistojnë.		

Data e transaksionit
Date / Data

Stamp / Vula

Bank Signature, seal and date
Nenshkrimi, vula dhe data

Client / Klienti - Signature / Nënshkrimi

Customer Declaration / Deklarata e klientit

Kjo formë është urdhër transfer, jo vërtetim i transferit. Duke dhënë nenshkrimin tim, unë kërkoj nga banka të ekzekutojë urdherin e transferit të parave në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të TEB S.H.A. Urdheri transferi do të ekzekutohet vetëm dhe nëse informacioni që unë kam dhënë është i saktë dhe i kompletuar, ka fonde të mjaftueshme në llogarinë time që banka të procesojë urdher transferin dhe unë nuk kam kërkuar në ndërkohë të anuloj urdher transferin e dhënë. Me këto unë pajtohem dhe jap pelqimin tim që banka mund të kolektojë nga llogaria ime shumën e transferit dhe të gjitha tarifat dhe shpenzimet e nevojshme. Në rast të anulimit të urdher transferit të parave si rezultat i informacionit të gabuar nga ana ime ose mungesës së fondeve, banka mund të vendosë një tarifë për anulimin e pagesës dhe mund të vendosë një tarifë për çdo lloj humbjeje në kursin valutuar të huaj që mund të ndodhë si rezultat i perpjekjes për të dërguar pagesën në emrin tim.

This form is transfer order, not the proof of transaction. By signing, I request to the bank to execute the money transfer order pursuant to the General Terms and Conditions. The transfer order shall be executed only and if the information I have provided is accurate and complete, there are sufficient funds in my account for the bank to process the transfer order and I have not requested in meantime to cancel the transfer order. I hereby agree and consent that the bank may deduct from my account transfer amount and all related fees and charges. In case of a cancelled money transfer order due to inaccurate information or insufficient funds from my side, the bank can make a charge for cancelling the payment and can make a charge for any loss in foreign exchange that may happen as a result of trying to send the payment on my behalf.

Shtojca 2: Kodet e SRTN-së me përshkrim të shkurtër

Kodi	Llogaria	Përshkrimi i shkurtër me shembuj
	1. MALLRAT	
110	Importi dhe eksporti i mallrave	Blerja/shitja e mallrave. Importi përfshin blerjen e mallrave (siç janë librat) nga jo rezidentët; Eksporti përfshin shitjet e mallrave (siç janë librat) jo rezidentëve.
111	Tregtimi (merchandising)	Tregtimi përcaktohet si blerja e mallrave nga një rezident (i ekonomisë përpiluese) tek një jo rezident, i kombinuar me rishitjen e mëvonshme të të njëjtave mallra tek një jo rezident tjetër, pa praninë fizike të mallrave në ekonominë përpiluese.
112	Ari jomonetar	Ari pluhur, dhe ari në forma të tjera jo të përpunuara ose gjysmë të prodhuara.
	2. SHËRBIMET	
210	Shërbimet e prodhimit për mallra në pronësi të tjerëve	Përpunimi, montimi, etiketimi, paketimi dhe procese të tjera të tilla të ndërmarrja nga ndërmarrje që nuk kanë në pronësi mallrat në fjalë. Vetëm tarifa (shërbimi prodhues) i ngarkuar nga ndërmarrja që merr përsipër shërbimin prodhues përfshihet në kuadër të këtij zëri.
211	Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit nga rezidentët në mallrat që janë në pronësi të jo rezidentëve (dhe anasjelltas). Riparimet mund të kryhen në vendin e riparuesit ose diku tjetër. Riparimet dhe mirëmbajtja në anije, avionë dhe pajisje të tjera të transportit përfshihen gjithashtu në këtë zë.
	SHËRBIMET E TRANSPORTIT	
	Transporti i pasagjerëve	
212	Transporti ajror	Pagesat dhe pranimet në lidhje me shërbimet e ofruara për pasagjerët përmes transportit ajror. Për shembull, shitjet e biletave, të ardhurat e fituara dhe të ngjashme.
213	Transporti detar	Pagesat dhe pranimet në lidhje me shërbimet e ofruara për udhëtarët përmes transportit detar. Për shembull, shitjet e biletave, të hyrat e fituara dhe të ngjashme.
214	Transporti rrugor dhe hekurudhor	Pagesat dhe pranimet në lidhje me shërbimet e ofruara për udhëtarët përmes transportit rrugor dhe hekurudhor. Për shembull, shitjet e biletave, të hyrat e pranuar dhe të ngjashme.

	Shërbimet e Transportit (Transporti i Mallrave)	
215	Transporti ajror	Transporti i mallrave përmes transportit ajror.
216	Transporti detar	Transporti i mallrave përmes transportit detar.
217	Rrugor dhe hekurudhor	Transporti i mallrave përmes transportit rrugor dhe hekurudhor.
	Shërbime të tjera mbështetëse dhe ndihmëse të transportit	
218	Transporti Ajror	Pilotazhi dhe ndihmesa e navigacionit për transportuesit, kontrolli i trafikut ajror, pastrimi i kryer në porte dhe aeroporte në pajisjet e transportit, operacionet e shpëtimit dhe tarifatat e agjentëve që lidhen me transportin e pasagjerëve dhe mallrave.
219	Transporti Detar	Tarifatat për trajtimin e ngarkesave të fatuara veçmas nga transporti, magazinimi dhe deponimi, paketimi dhe ripaketimi, rimorkimi që nuk përfshihet në shërbimet e transportit të mallrave në lidhje me transportin detar.
220	Rrugor dhe hekurudhor	Shërbimet në lidhje me transportin rrugor dhe hekurudhor.
221	Transporti nëpërmjet tubacionit	Transporti i mallrave nëpërmjet tubacioneve.
222	Transmetimi i energjisë elektrike	Transmetimi i energjisë elektrike. Shitja/blerja e energjisë elektrike regjistrohet nën import/eksport dhe nuk përfshihet në këtë zë.
223	Shërbime të transportit postar dhe shërbimet ndërlidhëse	Pranimi, transporti dhe dërgimi i letrave, gazetave, revistave periodike, broshurave, materialeve të tjera të shtypura, parcelave dhe paketave. Ato përfshijnë gjithashtu shërbimet postare të sportelit, siç janë shitjet e pullave dhe shërbimet e marrjes së një kutie postare. Shërbimet ndërlidhëse përfshijnë dërgesat ekspres dhe ato derë më derë.
	SHËRBIMET E UDHËTIMIT	
224	Udhëtim biznesi	Mallrat dhe shërbimet e pranuar për përdorim personal nga persona, qëllimi kryesor i udhëtimit të të cilëve është ai biznesor. P.sh. përfshinë konferencat, trajnimet dhe të ngjashme.
	Udhëtimi personal	

225	Udhëtimi për qëllime shëndetësore	Udhëtimi personal për qëllime shëndetësore përfshin shërbime të lidhura me shëndetin (p.sh., shërbime mjekësore, kujdes tjetër shëndetësor, ushqimi dhe akomodimi, transporti lokal, etj. të marra nga ata që udhëtojnë për arsye mjekësore).
226	Udhëtimi për qëllime arsimore	Udhëtimi personal për qëllime arsimore përfshin shërbime të lidhura me arsimin (p.sh., shkollimi, ushqimi dhe akomodimi, dhe transportin lokal, shërbimet shëndetësore, të marra nga studentë jo rezidentë).
227	Shërbimet e tjera të udhëtimit	Blerja e mallrave jashtë vendit, shërbimet e transportit lokal, shërbimet e akomodimit dhe shërbimet e ushqimit.
SHËRBIMET E NDËRTIMIT		
228	Ndërtimi jashtë vendit	Puna ndërtimore për jo rezidentët nga ndërmarrjet rezidente në ekonominë përpiluese (kredit), dhe mallrat dhe shërbimet e fituara nga ekonomia në të cilën veprimtaria e ndërtimit po ndërmerret nga këto ndërmarrje (debit).
229	Ndërtimi në Kosovë	Puna ndërtimore për rezidentët e ekonomisë përpiluese nga ndërmarrje ndërtimi jo rezidente (debit), dhe (b) mallrat dhe shërbimet e fituara në ekonominë përpiluese nga ndërmarrjet rezidente nga këto ndërmarrje ndërtimi jo rezidente (kredit).
SHËRBIMET E SIGURIMIT DHE PENSIONEVE		
230	Sigurimi i drejtpërdrejtë	Ndërmjet një kompanie sigurimesh dhe publikut. Nuk përfshin agjentë sigurimesh ose ndërmjetës .
231	Sigurimi i jetës	Sigurimi i jetës përfshin një varg pagesash nga mbajtësi i policës në këmbim të një shume njëherëshe në përfundim të policës.
232	Sigurimi i mallrave	Primet e sigurimit të mallrave të pagueshme në mallrat e tregtuara ndërkombëtare para se të arrijnë kufirin doganor të ekonomisë së eksportuesit, përfshihen në çmimin FOB të mallit. Primet e sigurimit të mallrave që paguhen pasi mallrat të largohen nga kufiri doganor i ekonomisë së eksportuesit, trajtohen si të pagueshme nga importuesi.
233	Risigurimi	Sigurimi ku të dy palët në policë janë ofrues të shërbimeve të sigurimit.
234	Shërbimet ndihmëse të sigurimit	Komisionet e agjentëve, shërbimet e ndërmjetësimit dhe të agjentëve, shërbimet e këshillimit të sigurimeve dhe pensioneve, shërbimet e vlerësimit dhe rregullimit të humbjeve, shërbimet aktuariale, shërbimet e administrimit të “shpëtimit” dhe shërbimet rregulluese dhe monitoruese mbi dëmshpërblimet dhe shërbimet e rikuperimit.
235	Pensionet dhe shërbimet e standardizuara të garantuara	Shërbimet pensionale: Shkalla e pretendimeve financiare që pensionistët ekzistues si dhe ata të ardhshëm mbajnë kundër punëdhënësit të tyre ose një fondi të caktuar nga punëdhënësi për të paguar pensionet e fituara si pjesë e një marrëveshjeje kompensimi midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

		Garancitë e standardizuara: nuk ofrohen nëpërmjet një derivativi financiar (siç janë kundërkëmbimet e mospagesës (mospërbushjes) së kreditit (ang. credit default swap- <i>marrëveshje për kompensim në rast mospagese të borxhit</i>), por për të cilat probabiliteti i mospagesës mund të përcaktohet qartë).
	SHËRBIMET FINANCIARE	
236	Shërbimet financiare	Marrja e depozitave dhe huadhënia, shërbimet e kartelave të kreditit, komisionet dhe tarifat që ndërlidhen me lizingun financiar ose të ngjashme; shërbimet këshilluese financiare, menaxhimi i aseteve financiare, shërbimet e sigurimit të likuiditetit, shërbime të bashkimit dhe blerjes, shërbime të vlerësimit kreditor, shërbime të bursës dhe shërbime të trustit.
	TARIFAT PËR PËRDORIMIN E PRONËS INTELEKTUALE	
237	Të drejtat pronësore	Patentat, markat tregtare, të drejtat e autorit, proceset dhe dizajnet industriale, duke përfshirë sekretet tregtare, franshizat.
238	Licencat për të përdorur dhe riprodhuar dhe shpërndarë	Të drejtat e autorit mbi libra dhe dorëshkrime, softuerë kompjuterikë, vepra kinematografike, dhe regjistrime zanore) dhe të drejtat e ndërlidhura (të tilla si për performancë të drejtpërdrejtë dhe transmetim televiziv, kabllor ose satelitor).
239	Shërbimet e telekomunikacionit	Transmetimi ose transmisioni i tingullit, imazheve, të dhënave ose informacioneve të tjera nëpërmjet telefonit, telegramit, radios dhe televizionit, dhe postës elektronike. Përfshihen gjithashtu shërbimet e telekomunikacionit mobil, shërbimet e shtyllës kryesore të Internetit dhe shërbimet e qasjes online, duke përfshirë ofrimin e qasjes në Internet.
	SHËRBIMET KOMPJUTERIKE	
240	Zhvillimi i softuerit	Konsulenca dhe implementimi i softuerëve, analiza, dizajnimi dhe zhvillimi i programimit; prodhimi, furnizimi dhe dokumentacioni i softuerit të personalizuar.
241	Shërbime të tjera kompjuterike	Shërbime për përpunimin e të dhënave, hostimi i ueb faqeve, zhvillimi dhe menaxhimi i databazave dhe shpërndarja e të dhënave.
	SHËRBIMET E INFORMACIONIT	
242	Shërbime të agjencive të lajmeve	Ofrimi i lajmeve, fotografive dhe artikujve për media. Përfshihen gjithashtu abonimet direkte jo me shumicë në gazeta dhe revista periodike dhe shërbime të tjera ofrimi përmbajtjeje online.
243	Shërbime të tjera informacioni	Konceptimi i bazës së të dhënave, ruajtja e të dhënave dhe shpërndarja e të dhënave dhe bazave të të dhënave (përfshirë direktoriet dhe lista postimi), si online ashtu edhe përmes mediave magnetike, optike, ose të shtypura; dhe portalet e kërkimit në internet).

	SHËRBIME TË TJERA BIZNESI	
244	Shërbime hulumtimi dhe zhvillimi	Hulumtime bazë, hulumtime aplikative dhe zhvillim eksperimental i produkteve dhe proceseve të reja.
	SHËRBIME KËSHILLIMI PROFESIONAL DHE MENAXHIMI	
245	Shërbime ligjore	Shërbime juridike të ofruara nga avokatë ose kompani juridike.
246	Përfaqësimi, dokumentimi, kontabiliteti, auditimi, libërmbajtja dhe shërbimet që lidhen me tatimet	Përfaqësimi, dokumentimi, kontabiliteti, auditimi, libërmbajtja, si dhe shërbime që lidhen me tatimet ose të ngjashme.
247	Shërbime të tjera profesionale dhe zhvillimore	Planifikimi, organizimi, projektimi i kostos, menaxhimi i burimeve njerëzore; marrëdhëniet me publikun, shërbimet e reklamimit; shërbime të ekspozimit në panairë tregtare; hulumtimi i tregut; dhe shërbimet e sondazheve të opinionit publik
	SHËRBIME TEKNIKE, TË NDËRLIDHURA ME TREGTINË DHE SHËRBIME TË TJERA BIZNESI	
248	Shërbime arkitekturore, të inxhinierisë dhe shërbime të tjera teknike;	Shërbime arkitekturore, të inxhinierisë dhe shërbime të tjera teknike
249	Shërbimet e trajtimit të mbeturinave, eliminimit të ndotjes, shërbimet bujqësore dhe minierave	Shërbimet e trajtimit të mbeturinave dhe eliminimit të ndotjes, shërbimet bujqësore dhe minierave

250	Shërbime të tjera biznesi të ndërlidhura me tregtinë	Komisionet mbi transaksionet e mallrave dhe shërbimeve të pagueshme tregtarëve, ndërmjetësve në mallra, tregtuesve, drejtuesve të ankandeve dhe agjentëve komisioni. Për shembull, këto shërbime përfshijnë tarifën e drejtuesit të ankandit ose komisionin e agjentit për shitjen e anijeve, avionëve dhe mallrave të tjera.
251	Lizingu Operativ	Marrja me qira e asetëve të prodhuara sipas aranzhimeve që parashohin përdorimin e një asemi të prekshëm nga qiramarrësi, por nuk përfshijnë transferimin e pjesës më të madhe të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë tek qiramarrësi.
SHËRBIMET PERSONALE, KULTURORE DHE REKREATIVE		
252	Shërbimet audio vizuale dhe të ndërlidhura	Prodhimi i fotografive lëvizëse (në film, videokasetë, disk, ose të transmetuara në mënyrë elektronike, etj.), Programe radio dhe televizive (drejtpërdrejtë ose në kasetë) dhe incizime muzikore.
253	Shërbime të tjera personale, kulturore dhe rekreative	Përfshinë pagesat për shërbime shëndetësore, shërbime arsimore dhe të tjera gjatë udhëtimit për qëllime rekreative.
MALLRAT DHE SHËRBIMET QEVERTARE N.I.E.(që nuk përfshihen diku tjetër)		
254	Ambasadat dhe konsullatat	Mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga dhe për ambasadat. Gjithashtu përfshin mallra dhe shërbime të marra nga shteti ku operojnë diplomatët dhe stafi konsullor i vendosur jashtë vendit dhe nga vartësit e tyre.
255	Njësitë ushtarake dhe agjencitë	Mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga dhe në baza ushtarake dhe organizata ndërkombëtare. Gjithashtu përfshin mallrat dhe shërbimet e marra nga shteti ku operojnë personeli ushtarak i vendosur jashtë vendit dhe vartësit e tyre
256	Mallrat dhe shërbimet e tjera qeveritare n.i.e.(që nuk përfshihen diku tjetër)	Shërbime të ofruara nga dhe për qeveritë dhe që nuk përfshihen në kategoritë e tjera të shërbimeve.
3. TË ARDHURAT		
310	Dividendët dhe tërheqjet	Fitimet e shpërndara për pronarët e ekuitetit, si rezultat i vendosjes së fondeve në dispozicion të korporatave.

311	Të ardhurat nga investimet në ekuitet dhe aksionet e fondeve investuese (investime portofoli)	Blerjet (debit) dhe shitjet (kredit) e: (i) letrave me vlerë të ekuitetit dhe letrave me vlerë të ngjashme të emetuara nga jo rezidentët-zotërimi më pak se 10 për qind; (ii) letrave me vlerë të borxhit (obligacionet dhe vlerënotat, dhe instrumentet e tregut të parasë) të emetuara përveç investitorëve direkt; (iii) shumat që vijnë nga transaksionet në terma, opsione, garanci dhe derivate të tjera financiare.
312	Interesi	Të ardhurat nga investimi që janë të arkëtueshme nga pronarët e llojeve të caktuara të asetëve financiare, përkatësisht depozitat, letrat me vlerë të borxhit, kreditë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme. Interesi paguhet për vendosjen e asetëve financiare në përdorim nga njësitë e tjera institucionale.
313	Tatimet dhe subvencionet në prodhim	(a) Tatimet mbi produktet, të cilat janë të pagueshme për njësi të një malli ose shërbimi. Shembujt përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, detyrimet e importit, taksat e eksportit dhe akcizën; dhe (b) Taksat e tjera mbi prodhimin. Shembujt përfshijnë tatimet e pagave, tatimet e përsëritura mbi ndërtesat dhe tokën, dhe licencat e biznesit.
314	Tatimet mbi të ardhurat, pasurinë	Tatimet e vendosura mbi të ardhurat e fituara nga jo rezidentët nga ofrimi i punës së tyre ose asetëve financiare.
315	Qiraja	Të ardhurat e arkëtueshme për vënie e burimeve natyrore në dispozicion të një njësie tjetër institucionale.
DËRGESAT (REMITANCAT) DHE TRANSFERET PËR INSTITUCIONE JOFITIMPRURËSE QË U SHËRBEJNË EKONOMIVE FAMILJARE (NPISHs)		
316	Kompensimi i punonjësve	Shpërblimi në këmbim të kontributit të punës në procesin e prodhimit të kontribuar nga një individ në një marrëdhënie punëdhënës-punonjës. Shembull: pagat mujore.
317	Përfitimet sociale që lidhen me fondet pensione dhe sigurimet shoqërore	Kontributet ose subvencionet e punëdhënësve për pensionet, sigurimin e jetës dhe sigurimin shëndetësor; shtesat për fëmijë, bashkëshort, familje, arsim ose pagesa të tjera në lidhje me personat e varur; pagesat e bëra për punonjësit që mungojnë nga puna për shkak të sëmundjes, dëmtimit aksidental, pushimit të lehonisë etj.
318	Kontributet sociale në skemat e pensioneve dhe skemat e sigurimeve shoqërore	Kontributet sociale të pagueshme nga punëdhënësit në fondet e sigurimeve shoqërore ose skemat e tjera të sigurimeve shoqërore të ndërlidhura me punësimin për të siguruar përfitime sociale për punonjësit e tyre.
319	Transferet personale	Të gjitha transferet tjera rrjedhëse në para ose në natyrë të bëra ose të pranuar nga ekonomitë familjare rezidente ose nga ekonomitë familjare jo rezidente

320	Lotaritë dhe lojërat e tjera të fatit	Shumat e paguara për tiketat e lotarisë ose të vendosura në baste që përfshijnë: (a) një tarifë shërbimi ndaj njësisë që organizon lotarinë ose lojërat e fatit (bixhozit) dhe (b) transferet rrjedhëse të pagueshme nga lojtarët bixhozi tek fituesit dhe, në disa raste, për bamirësi
321	Transferet përmes operatorëve të transferit të parave që nuk përfshihen më sipër	Të gjitha korporatat financiare që janë të angazhuara kryesisht në aktivitete që ndërlidhen me transaksione në asete dhe detyrime financiare ose me sigurimin e kontekstit rregullator për këto transaksione
322	Fondet e dërguara nga individë për depozitim në llogari vetanake bankare	Fonde të transferuara nga individë për depozitim në llogari vetanake bankare për qëllime të kursimit ose të tjera
323	Primet dhe dëmet e sigurimit jo i jetës (siguruesi dhe i siguruari)	Primet e sigurimit jo i jetës, primet e pagueshme nga policëmbajtësit për të marrë sigurim gjatë periudhës së kontabilitetit (primet e fituara) dhe shtesat e primit që paguhet për mbajtësit e policave të sigurimit. Dëmet janë shumat e pagueshme për shlyerjen e pretendimeve të arrira gjatë periudhës aktuale kontabël
324	Transfere të tjera të ndryshme	Transferet e tjera që nuk përmenden në kategorinë aktuale.
4.BASHKËPUNIMI AKTUAL NDËRKOMBËTAR		
NDIHMA E JASHTME ZHVILLIMORE NDËRMJET QEVERIVE		
410	Transferet rrjedhëse dhe asistencë teknike	Asistenca teknike duhet të regjistrohet si eksport i një shërbimi nga shteti dhurues në shtetin pranues. Ajo përfshin një shumëllojshmëri të gjerë shërbimesh të ndryshme, përfshirë shërbimet llogaritare dhe të biznesit dhe duhet të klasifikohen sipas natyrës së shërbimit të ofruar në shërbime specifike, nëse është e mundur.
411	Transferet kapitale (grante të mëdha investimesh)	Transfere në para ose në formë mallrash të bëra nga qeveritë ose organizatat ndërkombëtare tek njësi të tjera institucionale për të financuar të gjithë ose një pjesë të kostove të blerjes së aseteve të tyre fikse. Marrësit mund të jenë qeveri ose entitete të tjera dhe qëllimi është formimi i kapitalit. Për shembull: Grantet e ofruara për projekte të mëdha ndërtimi.
412	Transferet tek institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë ekonomive	Donacionet, në para ose në formë mallrash nga sektorët qeveritarë dhe të ndërmarrjeve për organizata bamirëse në një ekonomi tjetër; ndihma private dhe zyrtare si dhe sponsorizimi ndërkufitar i veprimtarive edukative dhe kulturore (përfshirë bursat).

	familjare (NPISH-të)	
413	Kontributet e paguara për organizatat ndërkombëtare	Transferet kapitale siç janë donacionet jashtëzakonisht të mëdha nga ekonomitë familjare ose ndërmarrjet për institucionet jofitimprurëse për të financuar formimin e kapitalit fiks bruto, siç janë dhuratat për universitete për të mbuluar kostot e ndërtimit të kolegjeve të reja vendore, bibliotekave dhe laboratorëve.
414	Të tjera	Transferet që nuk përfshihen në kategoritë e mëparshme
5.ASETET JOFINANCIARE TË PRODHUARA DHE JO TË PRODHUARA		
510	Kriptoalutat (Bitcoin & kripto asetet e ngjashme)	Përfaqësimet digjitale të vlerës, të bëra të mundshme nga përparimet në kriptografi dhe teknologjinë e librit kryesor të përbashkët të llogarive (ang. distributed ledger technology (DLT)). BLCA janë një lloj i kripto asetëve, të dizajnuara për të funksionuar si një mjet këmbimi. Shembuj të BLCA janë: Bitcoin, Ether, Ripple (XRP), Bitcoin Cash, EOS, Stellar dhe Litecoin.
512	Shitjet e asetëve jofinanciare jo të prodhuara (pranimet)	Shitjet e asetëve jofinanciare jo të prodhuara, të cilat përfshijnë burimet natyrore, kontratat, qiratë dhe licencat, asetet e marketingut .
513	Blerjet e asetëve jofinanciare jo të prodhuara (pagesat)	Blerjet e asetëve jofinanciare jo të prodhuara, të cilat përfshijnë burimet natyrore, kontratat, qiratë dhe licencat, asetet e marketingut .
6.INVESTIMI DIREKT (ID)		
ID JASHTË VENDIT		
EKUITETI		
610	Blerja e pasurive të paluajtshme jashtë vendit	Pagesat dhe pranimet në lidhje me investimet private/shitjen e pasurive të paluajtshme jashtë vendit nga rezidentët.
611	ID nga investitorë nga Kosova në ndërmarrje investimesh direkte (NID) jashtë vendit	Formimi i një interesi të qëndrueshëm në mes të një ndërmarrjeje rezidente në Kosovë (investitor direkt) në një ndërmarrjeje jo rezidente (ndërmarrje investimesh direkte). Ushtrimi i kontrollit ose ndikimit në ndërmarrjet jo rezidente është dëshmi e një marrëdhënieje të tillë.

612	Investime të kundërta (NID blen ekuitet në ID të saj në Kosovë)	Investimi i kundërt lind kur një ndërmarrje investimesh direkte i jep hua fonde ose blen ekuitet në investitorin e saj direkt imediat ose indirekt, me kusht që të mos zotërojë ekuitet që përbën 10 përqind ose më shumë të fuqisë votuese në atë investitor direkt që gjendet në Kosovë.
613	Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” (ang. fellow enterprises-FE) (asnjëra nga FE nuk e kontrollon FE-në tjetër)	Një ndërmarrje është një ndërmarrje “simotër” e një ndërmarrje tjetër nëse të dy ndërmarrjet kanë të njëjtin investitor direkt imediat ose indirekt, por asnjëra nuk është një investitor direkt imediat ose indirekt në tjetrën.
INSTRUMENTET E BORXHIT (HUAT NDËR-KOMPANI/KREDITË TREGTARE ME NDËRMARRJEN AMË)		
614	ID nga Kosova ofron një hua ose kredi tregtare për NID-në e saj jashtë vendit	Ofrimi i huave ose kredisë tregtare nga një investitor direkt rezident për ndërmarrjen e tij të investimeve direkte, e cila ndodhet jashtë vendit.
615	Investimet e kundërta (ID merr hua në NID-në e saj në Kosovë)	Investimi i kundërt lind kur një investitor direkt merr hua nga ndërmarrja e tij e investimeve direkte, e cila ndodhet në Kosovë.
616	Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra”	Një ndërmarrje investimesh direkte ose një ndërmarrje “simotër” mund të ketë hua ose balance të detyruara ndërmarrjeve “simotra” jashtë vendit ose hua ose balance nga ndërmarrjet “simotra” jashtë vendit. Asnjëra prej këtyre ndërmarrjeve të ndërlidhura nuk ka nevojë të zotërojë 10% ose më shumë të fuqisë votuese në tjetrën për sa kohë që ato kanë në mënyrë direkte ose indirekte një ndërmarrje amë të përbashkët.
ID NË KOSOVË		
EKUITETI		
617	Investimi nga emigrantët në pasuri të paluajtshme	Investimet private nga ana e jo rezidentëve në pasuri të paluajtshme në Kosovë (për shembull, blerja e resorteve ose rezidencave të tjera në Kosovë nga ana e jo rezidentëve për qëllime personale ose për dhënie me qira). Remitencat me vlerë prej EUR >15,000 dhe pa përshkrim të qartë konsiderohen gjithashtu si investime në pasuri të paluajtshme në Kosovë.

618	Investimi nga të gjithë jo rezidentët e tjerë në pasuri të paluajtshme në Kosovë	Investimet private nga ana e jo rezidentëve në pasuri të paluajtshme në Kosovë (për shembull, blerja e resorteve ose rezidencave të tjera në Kosovë nga ana e jo-rezidentëve për qëllime personale ose për dhënie me qira)
619	ID i jashtëm investon në NID në Kosovë	Formimi i një interesi të qëndrueshëm në mes të një ndërmarrjeje jashtë vendit (investitor direkt) dhe një ndërmarrjeje në Kosovë (ndërmarrje investimesh direkte). Pronësia direkte ose indirekte e 10% ose më shumë të fuqisë votuese të një ndërmarrjeje rezidente në një ekonomi nga ana e një investitori rezident në ekonomi tjetër është dëshmi e një marrëdhënieje të tillë.
620	Investimet e kundërta (NID blen ekuitet në ID-në e saj jashtë vendit)	Investimi i kundërt lind kur një ndërmarrje investimesh direkte i jep hua fonde ose blen ekuitet në investitorin e saj direkt imediat ose indirekt, me kusht që të mos zotërojë ekuitet prej 10 përqind ose më shumë të fuqisë votuese në atë investitor direkt që gjendet jashtë vendit.
621	Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra”	Një ndërmarrje është ndërmarrje “simotër” e një ndërmarrjeje tjetër në rastet kur të dy ndërmarrjet kanë të njëjtin investitor direkt imediat ose indirekt, por asnjëra nuk është investitor direkt imediat ose indirekt në tjetrën
INSTRUMENTET E BORXHIT		
622	ID jashtë vendit investon në NID në Kosovë	Ofrimi i huave ose kreditit tregtar nga ana e investitorit direkt jo rezident për ndërmarrjen e saj të investimeve direkte, e cila është e vendosur në Kosovë.
623	Investimet e kundërta (ID merr hua në NID-në e saj jashtë vendit)	Investimi i kundërt lind kur një investitor direkt merr hua nga ndërmarrja e tij e investimeve direkte, e cila gjendet jashtë vendit.
624	Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra”	Një ndërmarrje investimesh direkte ose ndërmarrje “simotër” mund të ketë gjithashtu hua ose bilance të detyruara ndërmarrjeve “simotra” jashtë vendit ose nga ndërmarrjet “simotra” jashtë vendit. Asnjë prej këtyre ndërmarrjeve të lidhura nuk ka nevojë të zotërojë 10% ose më shumë të fuqisë votuese në tjetrën për sa kohë që ato kanë, në mënyrë direkte ose indirekte, një kompani amë të përbashkët.
7. INVESTIMET PORTOFOLI (IP)		
710	Aksionet e listuara të ekuitetit	Aksionet e listuara janë ato të cilat janë të listuara në bursë dhe ndonjëherë mund të referohen edhe si aksione të kuotuar. Ekzistenca e çmimeve të kuotuar të aksioneve të listuara në bursë do të thotë që çmimet aktuale të tregut janë zakonisht lehtësisht të disponueshme

711	Aksionet jo të listuara të ekuitetit	Aksionet jo të listuara nganjëherë mund të quhen edhe si ekuitet privat (kapitali sipërmarrës shpesh merr këtë formë). Ekuiteti privat i referohet si burim të fondeve të ekuitetit tregjeve private; megjithatë, ekuiteti privat mund të përdoret për të investuar në aksione të listuara, duke përfshirë këtu edhe marrjen e kompanive të listuara publikisht, dhe delistimin (largimin nga lista) e tyre
712	Aksionet e fondit të investimeve	Emetohen nga fondet e investimeve, dëshmohen me anë të letrave me vlerë dhe nuk janë asete rezervë ose investim direkt; do të përfshihen në investimet e portfolios.
713	Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë (më shumë se një vit)	Bonot, obligacionet (premtimet) e pagarantuara, letrat komerciale, dëftesa borxhi, certifikata e depozitës dhe letra të tjera të tregtueshme me vlerë jo të ekuitetit përveç derivateve financiare. Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë përfshijnë instrumentet e emetuara me maturitet origjinal prej > 12 muaj të ofruara nga jo rezidentët për rezidentët dhe anasjelltas.
714	Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër (1 vit ose më pak)	Bonot, obligacionet e pagarantuara (debentures), letrat komerciale, dëftesat e borxhit, certifikatat e depozitës dhe letra të tjera të tregtueshme me vlerë jo të ekuitetit përveç derivateve financiare. Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër përfshijnë instrumentet e emetuara me maturitet origjinal prej ≤ 12 të ofruara nga jorezidentët për rezidentët dhe anasjelltas.
8.DERIVATIVET FINANCIARE		
810	Kontratat paraprake (ang. forwards)	Një kontratë e pakushtëzuar me anë të së cilës dy palë bien dakord të shkëmbejnë një sasi të specifikuar të një artikulli themelor (real ose financiar) me një çmim të kontratës të rënë dakord (çmimi i goditur) në një datë të specifikuar
812	Kontratat e opsioneve, kontratat e të ardhmes, garancitë, kundërkëmbimet, etj.	<p>Kontratë opsionesh: blerësi merr nga shitësi një të drejtë për të blerë ose shitur (në varësi të asaj nëse opsioni është “blej” ose “shit” e një artikulli themelor të specifikuar me një çmim të goditur në ose para datës së specifikuar.</p> <p>Kundërkëmbim: shkëmbim borxhi - zakonisht me zbritje - për një pretendim jo-borxhi si ekuiteti, ose për fondet e palës së kundërt që mund të përdoren për të financuar një projekt ose politikë të veçantë.</p> <p>Garancitë: Një formë opsioni derivativi financiar që i jep pronarit të drejtën, por jo edhe detyrimin, për të blerë nga emetuesi i garancisë një shumë fikse të asetit themelor, siç janë ekuitetet dhe bonot, me një çmim të kontratës të dakorduar për një periudhë të caktuar kohore ose në një datë të specifikuar.</p>
9.INVESTIMET E TJERA		

910	Ekuitetet që nuk janë pjesë e ID dhe IP	Ekuiteti që nuk është në formën e letrave me vlerë. Ekuiteti tjetër përfshihet në investime të tjera, në rastet kur nuk është investim direkt ose aset rezervë.
911	Depozitat	Të gjitha pretendimet që janë (a) në bankën qendrore, korporata depozitarrëse, përveç bankës qendrore, dhe, në disa raste, njësi të tjera institucionale; dhe (b) të përfaqësuara nga prova e depozitimit.
912	Huat, afatgjata	Asetet financiare që (a) krijohen kur një kreditor i jep hua fonde direkt një debitori, dhe (b) dëshmohen nga dokumente që nuk janë të negociueshme. Këtu përfshihen huat me kohëzgjatje më shumë se një vit.
913	Huat, afatshkurtra	Asetet financiare që (a) krijohen kur një kreditor i jep hua fonde direkt debitorit, dhe (b) dëshmohen nga dokumente që nuk janë të negociueshme. Këtu përfshihen huat me kohëzgjatje më pak se një vit.
914	Llogaritë e tjera të arkëtueshme / të pagueshme	Avanset dhe pagesat e shtyra në lidhje me shkëmbimin e aseteve jo të prodhuara.
10.ASETET E REZERVËS		
101	Ari monetar	Ari për të cilin autoritetet monetare (ose të tjerët që i nënshtrohen kontrollit efektiv të autoriteteve monetare) janë titullarë dhe mbahet si asete të rezervës.
102	Të drejtat speciale të tërheqjes (tirazhit) (SDR)	Asetet e rezervave ndërkombëtare të krijuara nga FMN dhe të alokuara për anëtarët për të plotësuar rezervat ekzistuese zyrtare
103	Pozicioni i rezervës në FMN	Shumat në valutë të huaj (përfshirë SDR-të) që një vend anëtar mund të tërheqë nga FMN me një periudhë të shkurtër njoftimi paraprak; dhe (b) çdo borxh i FMN-së (sipas një marrëveshje huaje) në Llogarinë e Burimeve të Përgjithshme që është lehtësisht e disponueshme për shtetin anëtar.
104	Depozitat	Depozitat me afat fiks dhe të disponueshme sipas kërkesës ose me periudhë të shkurtër njoftimi paraprak pa ndikuar panevojshëm në vlerën e depozitës. Depozitat e përfshira në asetet e rezervës janë ato që mbahen në bankat qendrore të huaja, Banka për Shlyerje Ndërkombëtare (BIS), dhe korporatat e tjera jorezidente depozitarrëse, dhe marrëveshjet e depozitave me llogaritë e trustit të FMN
105	Letrat me vlerë	Letrat me vlerë janë instrumente borxhi dhe ekuiteti që kanë tiparin karakteristik të negociueshmërisë. Në asetet e rezervës, letrat me vlerë përfshijnë ekuitetin likuid dhe të tregtueshëm dhe letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga jorezidentët.
106	Pretendimet tjera	Huat për korporatat jorezidente jodepozitarrëse, huat afatgjata për një llogari trusti të FMN-së, të cilat janë lehtësisht të ripagueshme për të përmbushur një nevojë financimi të bilancit të pagesave, huat që rrjedhin nga një repo e anasjelltë (përveç nëse klasifikohen si depozita), dhe asete të tjera financiare jo të përfshirë më parë por që janë asete në valutë të huaj që janë në dispozicion për përdorim të menjëhershëm.

Shtojca 3. Kodet e SRTN-së me shënime shpjeguese

MALLRAT

Mallrat janë artikuj fizik, të prodhuar mbi të cilat mund të përvendosen të drejta të pronësisë dhe pronësia ekonomike e të cilave mund të kalohet nga një njësi institucionale në tjetrën nëpërmjet hyrjes në transaksione. Ato mund të përdoren për të përmbushur nevojat ose dëshirat e ekonomive familjare ose komunitetit ose të përdoren për të prodhuar mallra ose shërbime të tjera. Mallrat paraqiten ndaras nga shërbimet. Importi i mallrave regjistrohet si debit, ndërsa eksporti i mallrave regjistrohet si kredit.

110 Importi dhe eksporti i mallrave

Pagesat nga rezidentët tek jo rezidentët për mallrat e importuara, ku, si rezultat, ndryshohet pronësia ekonomike (Importet). Pagesat e pranuar nga rezidentët prej jo rezidentëve lidhur me eksportin e mallrave (Eksporti).

111 Tregtimi

Transaksion tregtimi, domethënë, blerja e mallrave nga një rezident (i ekonomisë përpiluese) prej një jorezidenti, të kombinuar me rishitjen e mëvonshme të të njëjtave mallra tek një jorezident tjetër, pa praninë e mallrave në ekonominë përpiluese - duhet të regjistrohet në bilancin e pagesave si transaksione në mallra. Ato përfshijnë si blerjet ashtu dhe shitjet.

112 Ari jomonetar

Ari jomonetar përfshin tërë arin përveç arit monetar. Ari monetar është në pronësi të autoriteteve monetare dhe mbahet si një aset rezervë. Ari jomonetar mund të jetë në formën e arit pluhur dhe arit në forma të tjera jo të përpunuara ose gjysmë të përpunuara. Stolitë, orët, etj. që përmbajnë ar përfshihen në mallra të përgjithshme (eksport/import), jo ari jomonetar. Një depozitë shufre ari në një llogari ari të pa-alokuar paraqitet si shkëmbim i arit jomonetar për një aset financiar; dhe një tërheqje është e kundërta, përveç rasteve kur të dyja palët janë autoritete monetare ose organizata ndërkombëtare. Të gjitha transaksionet në ar jomonetar midis rezidentëve dhe jorezidentëve regjistrohen edhe në rastet kur nuk ka liferim fizik tek pronari i ri - për shembull, kur ari jomonetar mbahet në një këmbimore ari.

SHËRBIMET

Mallrat janë artikuj fizik, të prodhuar mbi të cilat mund të përvendosen të drejta të pronësisë dhe pronësia ekonomike e të cilave mund të kalohet nga një njësi institucionale tek tjetra nëpërmjet hyrjes në transaksione. Ato mund të përdoren për të përmbushur nevojat ose dëshirat e ekonomive familjare ose komunitetit ose të përdoren për të prodhuar mallra ose shërbime të tjera. Mallrat paraqiten ndaras nga shërbimet. Importi i mallrave regjistrohet si debit, ndërsa eksporti i mallrave regjistrohet si kredit.

210 Shërbimet e prodhimit për mallrat në pronësi të të tjerëve

Shërbimet e prodhimit për mallrat në pronësi të të tjerëve mbulojnë përpunimin, montimin, etiketimin, paketimin etj. të ndërmarrë nga ana e ndërmarrjeve që nuk zotërojnë mallrat në fjalë. Prodhimi ndërmerret nga një subjekt që nuk zotëron mallrat dhe që i paguhet një tarifë nga ana e pronarit. Në raste të tilla, pronësia e mallrave nuk ndryshon, dhe rrjedhimisht asnjë transaksion i përgjithshëm i mallrave nuk regjistrohet midis përpunuesit dhe pronarit.

211 Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit

Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit mbulojnë punët e mirëmbajtjes dhe riparimit të kryera nga rezidentët në mallrat që janë në pronësi të jo rezidentëve (dhe anasjelltas). Riparimet mund të kryhen në vendndodhje të riparuesit ose diku tjetër. Riparimet dhe mirëmbajtja në anije, avionë dhe pajisje të tjera të transportit përfshihen në kuadër të këtij zëri. Pastrimi i pajisjeve të transportit përfshihet në shërbimet e

transportit. Mirëmbajtja dhe riparimet e ndërtimeve janë të përjashtuara; ato përfshihen te ndërtimi. Mirëmbajtja dhe riparimet e kompjuterëve përfshihen në shërbimet kompjuterike.

SHËRBIMET E TRANSPORTIT

Transporti paraqet procesin e transportimit të njerëzve dhe objekteve nga një lokacion në tjetrin, si dhe shërbimet e lidhura mbështetëse dhe ndihmëse. Shërbime postare dhe korriere përfshihen gjithashtu këtu. Transporti mund të klasifikohet në bazë të: (a) mënyrës së transportit, gjegjësisht, detar, ajror ose tjetër ("tjera" mund të ndahet tutje në transport hekurudhor, rrugor, rrugë ujore të brendshme, tubacione dhe transport hapësinor, si dhe transmisioni i energjisë elektrike) ; dhe (b) asaj që bartet (transportohet) — pasagjerë ose mallra.

Shërbimet e pasagjerëve

Shërbimet e pasagjerëve përfshijnë transportin e njerëzve. Kjo kategori i përfshin të gjitha shërbimet e ofruara në transportin ndërkombëtar të jo rezidentëve nga transportuesit rezidentë (kredit) dhe atë të rezidentëve nga transportuesit jo rezidentë (debit). Përfshihen gjithashtu shërbime të pasagjerëve të kryera brenda një territori nga transportuesit jo rezidentë. Vlerësimi i transportit të pasagjerëve duhet të përfshijë tarifën e pagueshme nga transportuesit për agjencitë e udhëtimit dhe ofruesit tjerë të shërbimeve të rezervimit.

212 Transport ajror

Përfshinë pagesat dhe pranimet lidhur me shërbimet e ofruara për pasagjerët përmes transportit ajror.

213 Transporti detar

Përfshinë pagesat dhe pranimet lidhur me shërbimet e ofruara për udhëtarët përmes transportit detar.

214 Transporti rrugor dhe hekurudhor

Përfshinë pagesat dhe pranimet lidhur me shërbimet e ofruara për pasagjerët përmes transportit rrugor dhe hekurudhor.

Shërbimet e mallrave

Shërbimet e transportit të mallrave mbulojnë transportin e objekteve përveç njerëzve. Trajtimi i shërbimeve të mallrave është konsekuencë e miratimit të FOB si parim i vlerësimit uniform për mallrat. Vlerësimi i FOB është si në kufirin doganor të ekonomisë eksportuese, kështu që: (a) të gjitha kostot e transportit deri në kufirin doganor paraqiten si të shkaktuara (bartura) nga eksportuesi, dhe (b) të gjitha kostot e transportit përtej kufirit doganor paraqiten si të shkaktuara nga importuesi.

215 Transporti ajror

Përfshinë pagesa dhe pranime që lidhen me transportin e mallrave përmes transportit ajror.

216 Transporti detar

Përfshinë pagesat dhe faturat që lidhen me transportin e mallrave përmes transportit ajror.

217 Transporti rrugor dhe hekurudhor

Përfshinë pagesa dhe pranime që kanë të bëjnë me transportin e mallrave, kryesisht përmes transportit rrugor dhe hekurudhor.

Shërbime të tjera mbështetëse dhe ndihmëse të transportit

Shërbime të tjera mbështetëse dhe ndihmëse të transportit përfshijnë shërbime që janë ndihmëse ndaj transportit dhe që nuk ofrohen direkt për lëvizjen e mallrave dhe personave. Kjo kategori përfshin tarifën e trajtimit të ngarkesave të faturuara veçmas nga transporti, ruajtja dhe depoimi, paketimi dhe ripaketimi, rimorkimi që nuk përfshihet në shërbimet e transportit, ndihmesa e pilotazhit dhe naviguese për

transportuesit, kontrolli i trafikut ajror, pastrimi i pajisjeve të transportit i kryer në porte dhe aeroporte, operacionet e shpëtimit dhe tarifave të agjentëve që lidhen me transportin e pasagjerëve dhe mallrave (p.sh., shërbimet e shpëtitimit të mallrave dhe ndërmjetësimit).

218 Transporti ajror

Përfshinë shërbime të ofruara në aeroporte si trajtimi i ngarkesave, depoimi dhe magazinimi, paketimi dhe ripaketimi, ndihmesa e pilotazhit dhe naviguese për transportuesit, kontrolli i trafikut ajror, pastrimi i pajisjeve të transportit i kryer në porte dhe aeroporte, operacionet e shpëtimit dhe tarifave të agjentëve që lidhen me transportin e pasagjerëve dhe mallrave.

219 Transporti detar

Përfshinë shërbime si trajtimi i ngarkesave, paketimi dhe ripaketimi etj., lidhur me transportin detar.

220 Transport rrugor dhe hekurudhor

Përfshinë shërbime që lidhen me transportin rrugor dhe hekurudhor.

221 Transporti nëpërmjet tubacionit

Transporti i mallrave përmes tubacioneve.

222 Transmisioni i energjisë elektrike

Transmisioni i energjisë elektrike. Shitja/blerja e energjisë elektrike regjistrohet si import/eksport dhe nuk përfshihet në këtë zë.

223 Shërbime të transportit postar dhe shërbimet ndërlidhëse

Këto shërbime përfshijnë marrjen, transportin dhe dërgesën e letrave, gazetave, revistave periodike, broshurave, materialeve të tjera të shtypura, parcelave dhe paketave. Ato gjithashtu përfshijnë shërbime postare në sportele, siç janë shitjet e pullave dhe shërbimet e marrjes me qira të kutive postare. Shërbimet postare përfshijnë gjithashtu shërbimet postare në sportele, të tilla si shitjet e pullave dhe urdhëresat e parasë, shërbimet *post restante*, shërbimet e telegramit, etj. Shërbimet ndërlidhëse përfshijnë dërgesat ekspres dhe derë më derë. Shërbimet e dërgesave ekspres mund të përfshijnë, për shembull, marrjen e dërgesave sipas kërkesës, ose dërgesat me kohë të caktuar.

SHËRBIMET E UDHËTIMIT

Kreditet e udhëtimit mbulojnë mallrat dhe shërbimet për përdorim vetanak ose që do t'u jepen të tjerëve dhe të cilat blihen në një ekonomi nga jo rezidentët gjatë vizitave në atë ekonomi. Debitet e udhëtimit mbulojnë mallra dhe shërbime për përdorim vetanak ose që do t'u jepen të tjerëve dhe të cilat blihen në ekonominë e tjera nga rezidentët gjatë vizitave në këto ekonomi të tjera.

224 Udhëtimet për qëllime të biznesit

Udhëtimi për qëllime të biznesit mbulon mallra dhe shërbime të blera për përdorim personal nga ana e personave, qëllimi kryesor i udhëtimit i të cilëve është ai biznesor.

Udhëtimi për qëllime personale

Udhëtimi për qëllime personale mbulon mallrat dhe shërbimet e blera nga ana e personave që shkojnë jashtë vendit për qëllime të tjera nga ato të biznesit, të tilla si pushime, pjesëmarrje në aktivitete rekreative dhe kulturore, vizita tek miqtë dhe të afërmit, pelegrinazhi, dhe qëllime arsimore dhe shëndetësore.

225 Udhëtimi për qëllimet shëndetësore

Udhëtimi personal për qëllime shëndetësore përfshin shërbime të lidhura me shëndetin (p.sh., shërbime mjekësore, kujdes tjetër shëndetësor, ushqim, akomodim, transport lokal, të përfituar nga ata që udhëtojnë për arsye mjekësore).

226 Udhëtimi për qëllime arsimore

Udhëtimi personal për qëllime arsimore përfshin shërbime të lidhura me arsimin (p.sh. pagesa e shkollimit, ushqimi, akomodimi, transporti lokal, shërbimet shëndetësore, të përfituara nga studentët jo rezidentë);

227 Të gjitha qëllimet e tjera

Përfshinë udhëtimet personale dhe afariste dhe i referohet blerjes së mallrave, shërbimeve të transportit lokal, shërbimeve të akomodimit, si dhe shërbimeve të ushqimit.

SHËRBIMET E NDËRTIMIT

228 Ndërtimi jashtë vendit

Ndërtimi jashtë vendit përfshin: (a) puna ndërtimore për jo rezidentët nga ana e ndërmarrjeve që janë rezidente në ekonominë përpiluese (kredit) dhe (b) mallrat dhe shërbimet e blera nga ekonomia në të cilën aktivitetet e ndërtimit po ndërmerren nga këto ndërmarrje (debit).

229 Ndërtimi në Kosovë

Ndërtimi në ekonominë përpiluese përbëhet nga (a) puna ndërtimore për rezidentët e ekonomisë përpiluese nga ana e ndërmarrjeve ndërtimore jo rezidente (debit) dhe (b) mallrat dhe shërbimet e blera në ekonominë përpiluese nga ana e ndërmarrjeve rezidente nga këto ndërmarrje ndërtimi jo rezidente (kredit).

SHËRBIME TË SIGURIMEVE DHE PENSIONIT

Shërbimet e sigurimeve dhe pensioneve përfshijnë shërbimet e ofrimit të sigurimit të jetës dhe anuiteteve, sigurimeve jo-jetë, risigurimit, sigurimit të mallrave, pensionet, garancitë e standardizuara dhe shërbimet ndihmëse ndaj sigurimit, skemat e pensioneve dhe skemat e standardizuara të garancisë.

230 Sigurimi i drejtpërdrejtë

Sigurimi i drejtpërdrejtë është midis një kompanie të sigurimeve dhe publikut.

231 Sigurim i jetës

Sigurimi i jetës përfshin një fluks të pagesave nga mbajtësi i policës në këmbim të një shume njëherësh në fund të policës. Anuitetet janë e kundërta, kur një fluks pagesash bëhet nga ana e siguresit në këmbim të një shumë të njëhershme në fillim të policës.

232 Sigurimi i mallrave

Sigurimi i mallrave është formë e sigurimit jo-jetë që ngre çështje të veçanta përkitazi me vlerësimin e mallrave. Ashtu si transporti i mallrave, identifikimi i asaj se kush paguan sigurimin dhe se a përfshihet në çmimin e mallit përcaktohet nga koncepti i vlerësimit të FOB. Primet e sigurimit të mallrave, të pagueshme në mallrat e tregtuara ndërkombëtare para se të arrijnë kufirin doganor të ekonomisë së eksportuesit, përfshihen në çmimin FOB të mallit. Primet e sigurimit të mallrave, të pagueshme pasi mallrat largohen nga kufiri doganor i ekonomisë së eksportuesit, trajtohen si të pagueshme nga importuesi.

233 Risigurimi

Risigurimi është sigurim ku të dyja palët në policë janë ofrues të shërbimeve të sigurimit.

234 Shërbimet ndihmëse të sigurimit

Shërbimet ndihmëse të sigurimit përbëhen nga ofrimi i shërbimeve që lidhen ngushtë me operacionet e sigurimeve dhe fondeve të pensioneve. Këtu përfshihen komisionet e agjentëve, brokerimi në sigurime dhe shërbime agjencie (ndërmjetësie), shërbimet e konsulencës së sigurimeve dhe pensioneve, shërbimet e vlerësimit dhe rregullimit të humbjeve, shërbimet aktuariale, shërbimet e administrimit të “shpëtimit”

dhe shërbimet rregullatore dhe monitoruese për shërbimet e zhdëmtimit dhe rikuperimit. Këto shërbime ngarkohen përmes tarifave të qarta.

235 Shërbimet e pensionit dhe të garancive të standardizuara

Të drejtat pensionale tregojnë shtrirjen e pretendimeve financiare, të mbajtura si nga pensionistët ekzistues ashtu dhe ata të ardhshëm, ndaj punëdhënësit të tyre ose një fondi të caktuar nga punëdhënësi për pagesën e pensioneve të fituara si pjesë e marrëveshjes së kompensimit midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Garancitë e standardizuara përcaktohen si ato të cilat nuk ofrohen me anë të një derivativi financiar (siç janë kundërkëmbimet e mospagesës (default) të kreditit), por për të cilat probabiliteti i mospagesës mund të përcaktohet qartë.

SHËRBIMET FINANCIARE

236 Shërbimet financiare

Shërbimet financiare mbulojnë shërbimet ndërmjetësuese dhe ndihmëse financiare, përveç shërbimeve të sigurimeve dhe fondeve pensionale. Këto shërbime përfshijnë ato që zakonisht ofrohen nga bankat dhe korporatat e tjera financiare.

Ato përfshijnë marrjen e depozitave dhe huadhënien, letërkreditë, shërbimet e kartelave të kreditit, komisionet dhe tarifat që lidhen me lizingun financiar, faktoringun, nënshkrimin (marrjen përsipër të rrezikut) dhe kliringun e pagesave. Këtu gjithashtu përfshihen shërbimet e këshillimit financiar, kujdestaria e aseteve financiare ose shufrave, menaxhimi i aseteve financiare, shërbimet e monitorimit, shërbimet e sigurimit të likuiditetit, shërbimet e marrjes së rrezikut të tjera nga sigurimet, shërbimet e bashkimeve dhe blerjeve, shërbimet e vlerësimit kreditor, shërbimet e bursës dhe shërbimet e trustit.

TARIFAT PËR PËRDORIMIN E PRONËS INTELEKTUALE

237 Të drejtat pronësore

Tarifat për përdorimin e të drejtave proprietare (të tilla si patentat, markat tregtare, të drejtat e autorit, proceset dhe dizajnet industriale, përfshirë sekretet tregtare, franshizat). Këto të drejta mund të lindin nga hulumtimi dhe zhvillimi, si dhe nga marketingu.

238 Licencat për përdorim, riprodhim dhe shpërndarje

Tarifat për licencat për riprodhim ose shpërndarje (ose të dyja) të pronësisë intelektuale të mishëruara në origjinalet e prodhuara ose prototipe (të tilla si të drejtat e autorit në libra dhe dorëshkrime, softuerë kompjuterik, vepra kinematografike, dhe incizime zanore) dhe të drejtat e lidhura (të tilla si ato për shfaqjet e drejtpërdrejta dhe transmetimi televiziv, kabllor, ose satelitor).

239 Shërbimet e telekomunikacionit

Shërbimet e telekomunikacionit përfshijnë transmetimin ose transmisionin e tingujve, imazheve, të dhënave ose informacioneve të tjera nëpërmjet telefonit, teleksit, telegramit, transmetimit kabllor radio dhe televiziv, satelit radio dhe televiziv, postë elektronike, faksimil, etj., duke përfshirë shërbimet biznesore të rrjetit, telekonferencat dhe shërbimet mbështetëse. Ato nuk përfshijnë vlerën e informacionit të transportuar. Këtu përfshihen gjithashtu shërbime të telekomunikacionit mobil, shërbime të shtyllës kryesore (backbone) të internetit dhe shërbime të qasjes online, duke përfshirë ofrimin e qasjes në Internet. Nga kjo përjashtohen shërbimet e instalimit për pajisjet e rrjetit telefonik (të përfshira në ndërtimtari) dhe shërbimet e bazës së të dhënave (të përfshira në shërbimet e informacionit).

SHËRBIMET KOMPJUTERIKE

Shërbimet kompjuterike përbëhen nga shërbimet e lidhura me harduerin dhe softuerin dhe shërbimet e procesimit të të dhënave. Nga shërbimet kompjuterike janë përjashtuar kurset e trajnimit për kompjuter që nuk janë dizajnuar për një përdorues specifik (përfshirë në shërbime të tjera personale, kulturore dhe rekreative). Tarifat lidhur me licencat për riprodhimin ose distribuimin e softuerëve (ose të dyja) të cilat përfshihen në tarifat për përdorimin e pronës intelektuale, gjithashtu janë të përjashtuara. Dhënia me qira e kompjuterëve pa operator përfshihet në lizingun operacional.

240 Zhvillimi i softuerit

Zhvillimi i softuerit përfshin konsulencën dhe implementimin e softuerit, analizën, dizajnimin dhe zhvillimin e programimit; prodhimin, furnizimin dhe dokumentimin e softuerit të personalizuar.

241 Shërbime të tjera kompjuterike të ndërlidhura

Kjo komponentë përfshin shërbime të përpunimit të të dhënave, hostimin e ueb faqeve, zhvillimin dhe menaxhimin e bazave të të dhënave dhe shpërndarjen e të dhënave.

SHËRBIMET E INFORMIMIT

Shërbimet e informimit përfshijnë shërbime të agjencive të lajmeve, të tilla si ofrimi i lajmeve, fotografive dhe artikuj të veçantë për media. Shërbime të tjera të ofrimit të informacionit përfshijnë shërbimet e bazës së të dhënave - konceptimin e bazës së të dhënave, ruajtjen e të dhënave dhe shpërndarjen e të dhënave dhe bazave të të dhënave (përfshirë direktoriet dhe listat postuese), si online ashtu edhe përmes mediave magnetike, optike ose të shtypura; dhe portaleve të kërkimit në internet (shërbimet e motorit të kërkimit të cilat gjejnë adresa të internetit për klientët që bëjnë kërkime me fjalë kyçe). Këtu përfshihen gjithashtu abonimet direkte jo me shumicë në gazeta dhe revista, qoftë përmes postës, transmetimit elektronik, ose mjeteve të tjera; shërbime të tjera për ofrimin e përmbajtjes online; dhe shërbime të bibliotekës dhe arkivit. (Gazetat dhe revistat me shumicë përfshihen në mallra të përgjithshme.) Përmbajtja e shkarkuar që nuk është softuer (përfshirë në shërbimet kompjuterike) ose audio dhe video (përfshirë në shërbimet audiovizuale dhe ato të ndërlidhura) përfshihet në shërbimet e informimit.

242 Shërbimet e agjencive të lajmeve

Shërbimet e agjencisë së lajmeve përfshijnë ofrimin e lajmeve, fotografive dhe artikujve për media.

243 Shërbimet e tjera të informimit

Shërbimet e tjera të informimit përfshijnë shërbime të tilla si konceptimi i bazës së të dhënave, ruajtja e të dhënave dhe shpërndarja e të dhënave. Ato përfshijnë gjithashtu ofrimin e ueb portaleve (motorëve të kërkimit).

244 Shërbimet e Hulumtimit dhe Zhvillimit

Shërbimet e hulumtimit dhe zhvillimit konsistojnë në shërbime që janë të lidhura me hulumtimin bazë, hulumtimin aplikativ dhe zhvillimin eksperimental të produkteve dhe proceseve të reja. Në parim, aktivitetet e tilla në shkencat fizike, shkencat shoqërore dhe shkencat humanitare janë të përfshira, së bashku me zhvillimin e sistemeve operative që përfaqësojnë përparimet teknologjike. Këtu gjithashtu përfshihet hulumtimi komercial lidhur me elektronikën, farmaceutikën dhe bioteknologjinë.

SHËRBIMET E KONSULENCËS PROFESIONALE DHE TË MENAXHIMIT

Shërbimet e konsulencës profesionale dhe të menaxhimit përfshijnë: (a) shërbime juridike, kontabilitet, konsulencë menaxheriale, shërbime menaxheriale dhe shërbime të marrëdhënieve publike; dhe (b) reklamimi, hulumtimi i tregut dhe shërbimet e sondazheve të opinionit publik.

245 Shërbimet ligjore

Përfshinë ofrimin e shërbimeve juridike nga ana e rezidentëve për jo rezidentët dhe anasjelltas.

246 Përfaqësimi, dokumentimi, kontabiliteti, auditimi, libërmbajtja dhe shërbimet që lidhen me tatimet

Ky komponent përfshin shërbime që lidhen me përfaqësimin, dokumentimin, kontabilitetin, auditimin, libërmbajtjen, si dhe ato që kanë të bëjnë me tatimet ose shërbime të ngjashme.

247 Shërbime të tjera profesionale dhe zhvillimore

Shërbimet e tjera profesionale dhe zhvillimore përfshijnë planifikimin, organizimin, projektimin e kostos, menaxhimin e burimeve njerëzore; marrëdhëniet me publikun, shërbimet e reklamimit; shërbime të ekspozimit në panairë tregtare; hulumtim i tregut; dhe shërbimet e sondazheve të opinionit publik.

SHËRBIMET TEKNIKE, SHËRBIMET E LIDHURA ME TREGTINË DHE SHËRBIMET E TJERA TË BIZNESIT

Shërbimet teknike, shërbimet e lidhura me tregtinë dhe shërbimet e tjera të biznesit përfshijnë: (a) shërbimet arkitekturale, inxhinierike dhe shërbimet e tjera teknike; (b) trajtimi i mbeturinave dhe çndotja, shërbimet bujqësore dhe të minierave (c) shërbime të lizingut operativ (d) shërbime të lidhura me tregtinë, dhe (e) shërbime të tjera biznesi (shërbime shpërndarjeje të lidhura me ujën, avullin, gazin, dhe produkte të tjerë të naftës dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, kur këto identifikohen veçmas nga shërbimet e transmissioinit; vendosja e personelit, siguria dhe shërbimet hetimore; përkthimi dhe interpretimi; shërbimet fotografike; botimi; pastrimi i ndërtesave dhe shërbimet e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu këtu përfshihen edhe paradhëniet e konfiskuara që nuk mund të specifikohen në ndonjë shërbim tjetër.

248 Shërbimet arkitekturale, të inxhinierisë dhe shërbime të tjera teknike

Ky komponent përfshin ofrimin e shërbimeve lidhur me arkitekturën, inxhinierinë, si dhe shërbimet e tjera teknike.

249 Trajtimi dhe eliminimi i ndotjes, shërbimet bujqësore dhe të minierave

Ky komponent përfshin ofrimin e shërbimeve në lidhje me trajtimin e mbeturinave dhe eliminimin e ndotjes, shërbimet bujqësore dhe ato të minierave.

250 Shërbime të tjera biznesi të lidhura me tregtinë

Shërbimet që lidhen me tregtinë mbulojnë komisionet për transaksionet e mallrave dhe shërbimeve, të pagueshme për tregtarët, ndërmjetësit e mallrave, tregtuesit, drejtuesit e ankandëve dhe agjentët e komisioneve. Për shembull, këto shërbime përfshijnë tarifën e drejtuesit të ankandit ose komisionin e agjentit për shitjen e anijeve, avionëve dhe mallrave të tjera.

251 Lizingu (qiraja) operativ

Lizingu operativ është aktiviteti i marrjes me qira të aseteve të prodhuara sipas aranzhimeve që sigurojnë përdorimin e një aseti të prekshëm për qiramarrësin (lizingmarrësin), por nuk përfshijnë transferimin e pjesës më të madhe të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë tek lizingmarrësi.

SHËRBIME PERSONALE, KULTURORE DHE TË NDËRLIDHURA

Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative përbëhen nga (a) shërbimet audiovizuale dhe të ndërlidhura dhe (b) shërbime të tjera personale, kulturore dhe rekreative.

252 Shërbimet audio vizuale dhe të ndërlidhura

Shërbimet audio vizuale dhe ato të ndërlidhura përbëhen nga shërbime dhe tarifa që lidhen me prodhimin e fotografive lëvizëse (në film, videokasetë, disk, ose të transmetuara në mënyrë elektronike, etj.), programe radio dhe televizive (drejtpërdrejtë ose në kasetë), dhe incizime muzikore.

253 Shërbime të tjera personale, kulturore dhe rekreative

Shërbime të tjera personale, kulturore dhe rekreative përfshijnë shërbimet shëndetësore, shërbimet arsimore dhe të tjera.

MALLRAT DHE SHËRBIMET QEVERTARE

Mallrat dhe shërbimet qeveritare të pa specifikuar diku tjetër mbulojnë: (a) mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga dhe për enklavat, të tilla si ambasadat, bazat ushtarake dhe organizatat ndërkombëtare; (b)

mallrat dhe shërbimet e blera prej ekonomisë pritëse nga ana e diplomatëve, personelit konsullor dhe personelit ushtarak të vendosur jashtë vendit dhe nga vartësit e tyre; dhe shërbime të ofruara nga dhe për qeveritë dhe të cilat nuk përfshihen në kategoritë e tjera të shërbimeve.

254 Ambasadat dhe konsullatat

Ky komponent përfshin mallra dhe shërbime të furnizuara nga dhe për ambasadat. Ai gjithashtu përfshin mallra dhe shërbime të blera prej ekonomisë pritëse nga ana e diplomatëve dhe stafit konsullor të vendosur jashtë vendit dhe nga vartësit e tyre.

255 Njësitë dhe agjencitë ushtarake

Ky komponent përfshin mallra dhe shërbime të furnizuara nga dhe për bazat ushtarake dhe organizatat ndërkombëtare. Ai gjithashtu përfshin mallra dhe shërbime të blera në ekonominë pritëse nga ana e personelit ushtarak dhe vartësit e tyre të vendosur jashtë vendit.

256 Mallra dhe shërbime të tjera qeveritare

Ky komponent përfshin shërbimet e furnizuara nga dhe për qeveritë dhe që nuk përfshihen në kategoritë e tjera të shërbimeve.

TË ARDHURAT

Përfshinë të ardhurat e arkëtueshme nga një kompani rezidente nga pronësia e saj e pretendimeve ndaj jo rezidentëve; dhe (2) të ardhurat e pagueshme nga një kompani rezidente si rezultat i detyrimeve të saj ndaj jo rezidentëve. Format e zakonshme të të ardhurave janë dividendët, shpërndarjet e fitimit dhe interesi.

310 Dividendët dhe tërheqjet

Dividendët janë fitimet e shpërndara të alokuara për pronarët e ekuitetit për vendosjen e fondeve në dispozicion të korporatave.

311 Të ardhurat nga investimet në ekuitet dhe aksionet e fondit të investimeve (investime portofoli)

Blerjet dhe shitjet e: (i) letrave me vlerë të ekuitetit dhe letrave me vlerë të ngjashme të emetuara nga ana e jo rezidentëve me pronësi më pak se 10 përqind; (ii) letrat me vlerë të borxhit (bonot dhe vlerënotat dhe instrumentet e tregut të parasë) të emetuara nga ana e personave përveç investitorëve direkt; (iii) shumat që vijnë nga transaksionet në terma, opsione, garanci dhe derivative të tjera financiare.

312 Interesi

Interesi është formë e të ardhurave nga investimi që është i arkëtueshëm nga pronarët e llojeve të caktuara të aseteve financiare siç janë depozitat, letrat me vlerë të borxhit, kreditë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme. Interesi paguhet për vendosjen e aseteve financiare në dispozicion të një njësie tjetër institucionale. Të ardhurat nga posedimet e SDR (të drejtat speciale të tërheqjes/tirazhit) dhe alokimet e SDR janë gjithashtu të përfshira në interes.

313 Taksat dhe subvencionet në prodhim

Taksat dhe subvencionet për produktet dhe prodhimin duhet të regjistrohen në llogarinë e të ardhurave parësore për të ruajtur konsistencën konceptuale me sistemin e llogarive kombëtare (SNA). SNA e vitit 2008 bën dallimin midis (a) Taksave mbi produktet, të cilat janë të pagueshme për njësi të mallit ose shërbimit. Këto mund të jenë tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrimet e importit, taksat e eksportit dhe akciza; dhe (b) Taksat e tjera mbi prodhimin siç janë tatimet e pagave, tatimet e përsëritura mbi ndërtesat dhe tokën, dhe licencat e biznesit.

314 Tatimet mbi të ardhurat dhe pasurinë

Tatimet aktuale mbi të ardhurat, pasurinë, etj., në llogaritë ndërkombëtare përbëhen kryesisht nga tatimet e vendosura në të ardhurat e fituara nga jorzidentët si rezultat i ofrimit të punës së tyre ose asetëve të tyre financiare. Tatimet mbi fitimet kapitale që rrjedhin nga asetet e jorzidentëve janë gjithashtu të përfshira. Tatimet mbi pagat dhe mëditjet e fituara nga ana e punonjësve jorzident regjistrohen si të pagueshme nga punonjësit jorzidentë. Tatimet mbi të ardhurat dhe fitimet kapitale nga asetet financiare mund të jenë të pagueshme nga individë, korporata, institucione jofitimprurëse, qeveri dhe organizata ndërkombëtare. Tatimet mbi interesin dhe dividendët regjistrohen si të pagueshme nga marrësit e interesit ose dividendëve. Tatimet mbi transaksionet financiare (siç janë tatimet për emetimin, blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë) që paguhen nga ana e jorzidentëve gjithashtu paraqesin transfere rrjedhëse. (Megjithatë, në rastet kur taksat e tilla klasifikohen si taksa të tjera mbi produktet dhe prodhimin në llogaritë kombëtare, sipas konvencionit, ato mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë në llogaritë ndërkombëtare për arsye të konsistencës.) Tatimet mbi të ardhurat dhe pasurinë mund të vendosen nga organizatat ndërkombëtare dhe të jenë të pagueshme direkt të njëjtave, të tilla si agjencitë e një unioni ekonomik. Taksat mbi qiranë dhe pronësinë e tokës trajtohen si të pagueshme nga ana e prodhuesve rezidentë ose njësitë institucionale rezidente nacionale.

315 Qiraja

Qiraja mbulon të ardhurat e arkëtueshme për vënien e resurseve natyrore në dispozicion të një njësie tjetër institucionale.

DËRGESAT DHE TRANSFERET TEK INSTITUCIONET JOFITIMPRURËSE QË U SHËRBEJNË EKONOMIVE FAMILJARE (NPISHS)

316 Kompensimi i punonjësve

Kompensimi i punonjësve paraqet shpërblimin e dhënë në këmbim të inputit të punës në procesin e prodhimit, të kontribuar nga ana e individit në një marrëdhënie punëdhënës-punonjës me ndërmarrjen.

317 Përfitimet sociale që lidhen me fondet e pensioneve dhe sigurimet shoqërore

Shembuj të benefiteve sociale përfshijnë kontributet e punëdhënësve ose subvencionet për pensionet, sigurimin e jetës dhe sigurimin shëndetësor; shtesat për fëmijë, bashkëshort, familje, arsim ose pagesa të tjera në lidhje me personat e varur; pagesa të bëra për punonjësit që mungojnë nga puna për shkak të sëmundjes, dëmtimit aksidental, pushimit të lehonisë etj. dhe pagesa për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Këtu përfshihen si kontributet shoqërore aktuale ashtu edhe ato të imputuara.

318 Kontributet sociale në skemat e pensioneve dhe skemat e sigurimeve shoqërore

Kontributet sociale të punëdhënësve janë kontributet sociale që paguhen nga ana e punëdhënësit tek fondet e sigurimeve shoqërore ose skemat e tjera të sigurimeve shoqërore të lidhura me punësimin për të siguruar përfitime sociale për punonjësit e tyre.

319 Transferet personale

Transferet personale përbëhen nga të gjitha transferet në para të gatshme ose në natyrë të bëra ose të marra nga ekonomitë familjare rezidente për ose nga ekonomitë familjare jorzidente (p.sh. shuma e paguar për biletat nga llotaritë dhe lojërat e fatit, si dhe transferet e parasë për fituesit ose shoqatat e bamirësisë)

320 Lotaritë dhe lojërat e tjera të fatit

Vlera e lotarisë dhe shërbimeve të tjera të lojërave të fatit të ofruara nga ose prej jorzidentëve vlerësohet si shuma e vënë bast nga jorzidentët shumëzuar me raportin (ratio-n) e përgjithshëm të shërbimeve ndaj shumës totale të vënë bast për atë operator të lojërave të fatit ose lloj të lojërave të fatit. Kjo metodë për identifikimin ndaras të komponentit të shërbimit është e ngjashme me metodën e përdorur për shërbimet e sigurimeve. Shumat e paguara për tiketat e llotarisë ose të vëna bast përbëhen nga: (a) tarifa e shërbimit ndaj njësisë që organizon llotarinë ose lojërat e fatit dhe (b) transferet aktuale që janë të pagueshme nga lojtarët tek fituesit dhe, në disa raste, tek shoqatat e bamirësisë. Transferet vlerësohet se bëhen direkt nga ata që marrin pjesë në llotari ose lojëra të fatit tek fituesit dhe shoqatat e bamirësisë. Kjo do të thotë se ato nuk regjistrohen si transfere në ose nga njësia që operon lojërat e fatit. Një pjesë e tarifave të shërbimit

me çmimet e blerësve mund të përfshijnë taksat e lojërave të fatit, të cilat tregohen si të pagueshme nga ana e operatorit, dhe jo nga ana e klientëve.

321 Transferet përmes operatorëve të transferit të parave që nuk përfshihen më sipër

Operatorët e parave janë nënsektor i ndihmësve financiarë, të cilët përfshijnë të gjitha korporatat financiare të angazhuara kryesisht në veprimtari që kanë të bëjnë me transaksione të aseteve dhe detyrimeve financiare ose me sigurimin e kontekstit rregullator për këto transaksione, por në rrethana që nuk përfshijnë marrjen në pronësi nga ana e ndihmësve financiar të aseteve dhe detyrimeve financiare që janë subjekt i transaksionit.

322 Fondet e dërguara nga individë për depozitim në llogarinë vetanake bankare

Ky komponent përfshin fondet e transferuara nga individë për depozitim në llogarinë vetanake bankare për qëllime të kursimit ose për qëllime të tjera.

323 Primet dhe pretendimet (dëmet) e sigurimit jo-jetë (siguruesi dhe i siguruari)

Primet e sigurimit jo-jetë përbëhen si nga primet bruto të pagueshme nga mbajtësit e policës për të marrë sigurim gjatë periudhës kontabël (primet e fituara) ashtu edhe nga shtesat e primeve të pagueshme prej të ardhurave të investimeve që i atribuohen mbajtësve të policave të sigurimit. Totali i primeve të sigurimit jo-jetë të pagueshme në këtë mënyrë duhet të mbulojë pagesat e tarifave të shërbimeve tek ndërmarrjet e sigurimeve për rregullimin e sigurimit dhe pagesat për vetë sigurimin. Dëmet (pretendimet) e sigurimit jo-jetë janë shumat e pagueshme për shlyerjen e pretendimeve që bëhen të arrira për pagesë gjatë periudhës aktuale të kontabilitetit. Kërkesat bëhen të detyrueshme në momentin kur ndodh eventualiteti që krijon pretendim valid.

324 Transferime të tjera të ndryshme

Ky komponent përfshin transfere të tjera që nuk përmenden në kategorinë aktuale.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR AKTUAL

Ndihma e huaj zhvillimore ndërmjet qeverive

410 Transferet rrjedhëse dhe asistencë teknike

Ndihma teknike e ofruar nga një entitet rezident në ekonominë donatore duhet të regjistrohet si eksport i një shërbimi nga ekonomia donatore në ekonominë pranuese. Ndihma teknike mbulon një larmi të gjerë shërbimesh të ndryshme, duke përfshirë shërbimet llogaritare dhe të biznesit dhe duhet të klasifikohet sipas natyrës së shërbimit të ofruar në shërbime specifike, nëse është e mundur. Ndihma teknike e ofruar nga qeveria ose një organizatë ndërkombëtare klasifikohet si shërbime qeveritare vetëm kur nuk klasifikohet në një shërbim specifik, dhe kur personeli i ndihmës teknike punësohet nga qeveria donatore ose një organizatë ndërkombëtare. Ndihma teknike mund t'i nënshtrohet pagësës nga marrësi ose të financohet nga një transfer rrjedhës ose kapital nga donatori. Kur ndihma teknike ndërkufitare ofrohet pa iu ngarkuar ndonjë tarifë marrësit, regjistrohet një transfer rrjedhës ose kapital për vlerën e shërbimeve të ofruara.

411 Transferet kapitale (grantet e mëdha investuese)

Grantet investive përbëhen nga transferet kapitale në para ose në natyrë të bëra nga qeveritë ose organizatat ndërkombëtare për njësi të tjera institucionale për të financuar të gjithë ose një pjesë të kostove të blerjes së aseteve të tyre fikse. Marrësit mund të jenë qeveri të tjera ose entitete të tjera. Marrësit janë të detyruar të përdorin grantet investive të marra në para për qëllime të formimit të kapitalit fiks bruto, dhe grantet shpesh janë të lidhura me projekte specifike investimesh, siç janë projektet e mëdha të ndërtimit. Grantet për investime të bëra nga organizata të tjera përveç qeverisë së përgjithshme dhe organizatat ndërkombëtare përbëjnë transfere të tjera kapitale.

412 Transferet për institucione jofitimprurëse që u shërbejnë ekonomive familjare (NPISH)

Transferet për NPISH-të përfshijnë donacionet, në para ose në natyrë, nga sektori i qeverisë dhe i ndërmarrjeve për organizatat bamirëse në një ekonomi tjetër. Gjithashtu, një pjesë e madhe e ndihmës private dhe zyrtare, si dhe e sponsorizimit ndërkufitar të veprimtarive edukative dhe kulturore (duke përfshirë bursat) do të përfshihet në kuadër të këtij zëri.

413 Kontributet që u paguhen organizatave ndërkombëtare

Transferet kapitale siç janë donacionet jashtëzakonisht të mëdha nga ekonomitë familjare ose ndërmarrjet për institucionet jofitimprurëse për të financuar formimin e kapitalit fiks bruto, siç janë dhuratat për universitetet për të mbuluar kostot e ndërtimit të kolegjeve të reja rezidenciale, bibliotekave dhe laboratorëve. Transferet kapitale gjithashtu përfshijnë grante në para nga qeveritë donatore ose institucionet financiare shumëpalëshe për ekonominë debitore që do të përdoren për të shlyer borxhin.

Një kontribut kapital për një organizatë ndërkombëtare ose një institucion jofitimprurës është një transfer kapital nëse nuk krijon ekuitet për kontributdhënësin.

414 Të tjera

Kjo kategori përfshin transferet që nuk janë përfshirë në kategoritë e mëparshme.

ASETET JOFINANCIARE, TË PRODHUARA DHE JO TË PRODHUARA

510 Kriptovalutat (Bitcoin dhe kripto asetet e ngjashme)

Kripto asetet janë përfaqësime digjitale të vlerës, të mundësuar nga përparimet në kriptografi dhe teknologjinë e regjistrave (librave të llogarive) të shpërndarë (DLT). BLCA-të janë njëri prej llojeve të kripto asetëve. Ato janë asetë dixhitale të bazuara në DLT dhe janë të projektuara ashtu që të funksionojnë si një medium shkëmbimi. Shembuj të BLCA-ve janë: Bitcoin, Eter, Ripple (XRP), Bitcoin Cash, EOS, Stellar dhe Litecoin. Në këtë doracak BLCA-ja përdoret në mënyrë specifike për të nënkuptuar ato kripto asetë që janë projektuar për të shërbyer si një medium i përgjithshëm këmbimi për pagesa ndërmjet kolegëve (ang. *peer-to-peer*), pa përgjegjësi të dërguesit dhe të kundërpalës. Kripto asetet kombinojnë veçoritë e valutave, mallrave dhe asetëve të paprekshme.

Ato konsiderohen si asetë jofinanciare, të prodhuara dhe regjistrohen ndaras si import/eksport.

512 Shitjet (heqjet) e asetëve jo të prodhuara jofinanciare (pranimet)

Asetet jo të prodhuara, jofinanciare përbëhen nga: (a) resurset natyrore; (b) kontratat, qiratë dhe licencat; dhe (c) asetet e marketingut (dhe emri i mirë). Resurset natyrore përfshijnë tokën, të drejtat minerare, të drejtat pyjore, ujin, të drejtat e peshkimit, hapësirën ajrore dhe spektrin elektromagnetik. Kontratat, qiratë dhe licencat mbulojnë ato kontrata, qira dhe licenca që njihen si asetë ekonomike. Asetet e marketingut përbëhen nga artikuj të tillë si emrat e markave, kryetitujt, markat tregtare, logot dhe emrat e domain-it.

Shitja (heqja) u referohet shitjeve të këtyre asetëve dhe regjistrohet në anën e kredisë.

513 Blerjet e asetëve jo të prodhuara jofinanciare (pagesat)

Asetet jo të prodhuara, jofinanciare përbëhen nga: (a) resurset natyrore; (b) kontratat, qiratë dhe licencat; dhe (c) asetet e marketingut (dhe emri i mirë). Resurset natyrore përfshijnë tokën, të drejtat minerare, të drejtat pyjore, ujin, të drejtat e peshkimit, hapësirën ajrore dhe spektrin elektromagnetik. Kontratat, qiratë dhe licencat mbulojnë ato kontrata, qira dhe licenca që njihen si asetë ekonomike. Asetet e marketingut përbëhen nga artikuj të tillë si emrat e markave, kryetitujt, markat tregtare, logot dhe emrat e domain-it.

Blerjet u referohen blerjeve të këtyre asetëve dhe regjistrohen në anën e debitit.

INVESTIMET DIREKTE

Investimet direkte jashtë vendit

Investimet direkte jashtë vendit mbulojnë asetet dhe detyrimet midis investitorëve rezidentë direkt dhe ndërmarrjeve të tyre të investimeve direkte. Ato gjithashtu përfshijnë asetet dhe detyrimet ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” rezidente dhe jorezidente nëse kompania amë përfundimtare kontrolluese është rezidente. Investimi direkt jashtë vendit quhet gjithashtu investim direkt i drejtuar jashtë.

Ekuiteti

Përfshin ekuitetin në degë, aksionet (pavarësisht nëse me të drejtë votimi ose jo) në filiale dhe pjesmarrje, si dhe kontributet e tjera kapitale (siç është ofrimi i makinerive nga një investitor direkt për një ndërmarrje të investimeve direkte) që përbëjnë pjesë të kapitalit të ndërmarrjes së investimeve direkte. Kapitali i ekuitetit gjithashtu përfshin blerjen nga një ndërmarrje investimesh direkte të aksioneve në investitorin e saj direkt.

610 Blerja e pasurisë së paluajtshme jashtë vendit

Pagesat dhe pranimet lidhur me investimet private/shitjen e pasurisë së paluajtshme jashtë vendit nga rezidentët.

611 ID-ja nga Kosova investon në ndërmarrje të investimeve direkte (NID) jashtë vendit (investimi direkt jashtë vendit)

Investimi direkt i huaj reflekton objektivin e krijimit të një interesi të qëndrueshëm nga një ndërmarrje rezidente në një ekonomi (investitor direkt) në një ndërmarrje (ndërmarrje të investimeve direkte) që është rezidente në një ekonomi tjetër nga ajo e investitorit direkt. Pronësia direkte ose indirekte e 10% ose më shumë të fuqisë votuese në një ndërmarrje rezidente në një ekonomi nga një investitor rezident në një ekonomi tjetër është dëshmi e një marrëdhënieje të tillë.

612 Investimet e kundërta (një NID jashtë vendit blen ekuitet në ID-në të saj në Kosovë)

Investimi i kundërt ndodh kur një ndërmarrje e investimeve direkte ka në pronësi një pjesë, por më pak se 10 për qind, të fuqisë votuese në investitorin e saj direkt imediat ose indirekt të vendosur në Kosovë.

613 Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” (blerja e ekuitetit)

Një ndërmarrje është ndërmarrje “simotër” e një ndërmarrjeje tjetër nëse të dyja ndërmarrjet kanë të njëjtin investitor direkt imediat ose indirekt, por asnjëra nuk është investitor direkt imediat ose indirekt në tjetrën.

Të gjitha asetet dhe detyrimet ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” tregohen në kuadër të investimeve direkte jashtë vendit kur kompania amë përfundimtare kontrolluese është rezident. Në atë rast, kontrolli dhe ndikimi ushtrohen nga ekonomia e rezidentit, kështu që është e dobishme që një investim në një ndërmarrje “simotër” jashtë vendit të konsiderohet në të njëjtën mënyrë si një investim i drejtuar jashtë.

INSTRUMENTET E BORXHIT (HUADHËNIA NDËRMJET KOMPANIVE)

Instrumentet e borxhit janë ato instrumente që kërkojnë pagesën e kryegjësë dhe/ose interesit në ndonjë pikë kohore në të ardhmen. Instrumentet e borxhit përfshijnë valutën, depozitat dhe letrat me vlerë të borxhit.

614 ID-ja nga Kosova i jep hua ose kredit tregtar NID-së së tij jashtë vendit

Huadhënia ndërmjet kompanive përdoret për të përshkruar pozicionet e borxhit të investimeve direkte ndërmjet ndërmarrjeve të lidhura. Ai përfshin transaksionet dhe pozicionet e instrumenteve të borxhit; nuk është i kufizuar në hua. Ky përbërës përfshin dhënien e huas ose kredisë tregtare nga një investitor direkt rezident për ndërmarrjen e tij të investimeve direkte, e cila ndodhet jashtë vendit.

615 Investimet e kundërta (ID-ja merr kredi në NID-në e tij në Kosovë)

Investimi i kundërt ndodh kur një ndërmarrje e investimeve direkte merr kredi nga investitori i saj direkt imediat ose indirekt i vendosur në Kosovë.

616 Ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” (blerja e instrumenteve të borxhit)

Një ndërmarrje e investimeve direkte ose një ndërmarrje “simotër” gjithashtu mund të ketë hua ose bilance që u detyrohen ndërmarrjeve të tjera “simotra” jashtë vendit ose për të cilat këto të fundit i detyrohen asaj. Asnjëra prej këtyre ndërmarrjeve të lidhura nuk ka nevojë të ketë fuqi votuese prej 10% ose më shumë në tjetrën për sa kohë që ato kanë një kompani amë të përbashkët qoftë drejtpërdrejt ose indirekt.

INVESTIMI DIREKT NË KOSOVË

Investimi direkt në ekonominë raportuese përfshin të gjitha detyrimet dhe asetet ndërmjet ndërmarrjeve rezidente të investimeve direkte dhe investitorëve të tyre direktë. Ai gjithashtu përfshin asetet dhe detyrimet ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” rezidente dhe jorezidente nëse kompania përfundimtare amë kontrolluese është jorezident. Investimi direkt në ekonominë raportuese quhet gjithashtu investim direkt i drejtuar nga brenda.

EKUITETI

Ekuiteti përbëhet nga të gjitha instrumentet dhe regjistrat që pranojnë pretendimet mbi vlerën e mbetur të një korporate ose kuazi-korporate pasi të jenë përbushur pretendimet e të gjithë kreditorëve. Ekuiteti trajtohet si një detyrim i njësisë institucionale emetuese (një korporatë ose njësi tjetër). Në BOP, kjo përfshin shitjen e aksioneve dhe të gjitha ekuiteteve të ngjashme nga ndërmarrjet rezidente në Kosovë që përfaqëson 10% të aksioneve.

617 Investimet nga migrantët në pasuri të paluajtshme

Investimet private nga jorezidentët në pasuri të paluajtshme në Kosovë (për shembull, blerja e resorteve ose rezidencave tjera në Kosovë nga jorezidentët për qëllime personale ose të dhënies me qira). Remitansat me vlerë prej mbi 15,000 euro dhe pa një përshkrim të qartë konsiderohen gjithashtu si investime në pasuri të paluajtshme në Kosovë.

618 Investimet nga të gjithë jorezidentët e tjerë në pasuri të paluajtshme në Kosovë

Investimi privat nga jorezidentët në pasuri të paluajtshme në Kosovë (për shembull, blerja e resorteve ose rezidencave të tjera në Kosovë nga jorezidentët për qëllime personale ose të dhënies me qira).

619 ID-ja jashtë vendit investon në NID-në në Kosovë

Investimi direkt i huaj reflekton objektivin e krijimit të një interesi të qëndrueshëm nga një ndërmarrje rezidente në një ekonomi (investitor direkt) në një ndërmarrje (ndërmarrje të investimeve direkte) që është rezidente në një ekonomi tjetër nga ajo e investitorit direkt. Pronësia direkte ose indirekte e 10% ose më shumë të fuqisë votuese të një ndërmarrje rezidente në një ekonomi nga një investitor rezident në një ekonomi tjetër është dëshmi e një marrëdhënieje të tillë.

620 Investimet e kundërta

Investimi i kundërt ndodh kur një ndërmarrje e investimeve direkte ka në pronësi një pjesë, por më pak se 10 për qind, të fuqisë votuese në investitorin e saj direkt imediat ose indirekt të vendosur jashtë vendit.

621 Ndërmjet kompanive “simotra” (blerja e ekuitetit)

Një ndërmarrje është ndërmarrje “simotër” e një ndërmarrje tjetër nëse të dyja ndërmarrjet kanë të njëjtin investitor direkt imediat ose indirekt, por asnjëra nuk është investitor direkt imediat ose indirekt në tjetrën.

Të gjitha asetet dhe detyrimet ndërmjet ndërmarrjeve “simotra” paraqiten në kuadër të investimeve direkte jashtë vendit kur kompania përfundimtare amë kontrolluese është rezident. Në atë rast, kontrolli dhe ndikimi ushtrohen nga ekonomia e rezidentit, kështu që është e dobishme që një investim në një ndërmarrje “simotër” jashtë vendit të konsiderohet në të njëjtën mënyrë si një investim i drejtuar jashtë.

INSTRUMENTET E BORXHIT

622 DI-ja jashtë vendit ofron një kredi ose kredi tregtare për DIE-në e saj në Kosovë

Huadhënia ndërmjet kompanive përdoret për të përshkruar pozicionet e borxhit të investimeve direkte midis ndërmarrjeve të ndërlidhura. Ajo përfshin transaksionet dhe pozicionet e instrumenteve të borxhit; nuk është e kufizuar vetëm në kredi. Ky komponent përfshin dhënien e kredive ose kredisë tregtare nga një investitor direkt jorezident për ndërmarrjen e tij të investimeve direkte, me vendndodhje në Kosovë.

623 Investimet e kundërta (ID-ja merr kredi nga DIE-ja e saj jashtë vendit)

Investimi i kundërt ndodh kur një ndërmarrje investimesh direkte merr kredi nga investitori i saj direkt imediat ose indirekt me vendndodhje jashtë vendit.

624 Midis ndërmarrjeve “simotra” (blerja e instrumenteve të borxhit)

Një ndërmarrje investimesh direkte ose një ndërmarrje “simotër” mund gjithashtu të ketë hua ose bilance të detyruara ndërmarrjeve “simotra” jashtë vendit ose nga ndërmarrjet “simotra” jashtë vendit. Asnjëra nga këto ndërmarrje të ndërlidhura nuk ka nevojë të mbajë 10% ose më shumë të fuqisë votuese në tjetrën, për sa kohë që ato në mënyrë direkte ose indirekte kanë një kompani amë të përbashkët.

INVESTIMET PORTOFOLI

710 Aksionet e listuara të ekuitetit

Aksionet e listuara janë ato të listuara në një bursë dhe ndonjëherë mund të referohen si aksione të kuotuar. Ekzistenca e çmimeve të kuotuar të aksioneve të listuara në bursë do të thotë që çmimet aktuale të tregut janë zakonisht lehtësisht të disponueshme. Përveç aspekteve të valuimit, aksionet e listuara priren të emetohen nga lloje të ndryshme të korporatave (njësitë vartëse (filialet) dhe bizneset më të vogla) dhe zakonisht kanë kërkesa të ndryshme rregullatore.

711 Aksionet e palistuar të ekuitetit (ekuiteti privat/kapitali sipërmarrës)

Aksionet e palistuar nganjëherë mund të referohen si ekuitet privat (kapitali sipërmarrës shpesh e merr këtë formë). Ekuiteti privat i referohet si burim i fondeve të ekuitetit tregjeve private; megjithatë, ekuiteti privat mund të përdoret për të investuar në aksione të listuara, përfshirë këtu marrjen e ndërmarrjeve publikisht të listuara, dhe delistimin (largimin nga lista) e tyre. Aksionet e palistuar gjithashtu priren të emetohen nga lloje të ndryshme të korporatave (njësitë ndihmëse dhe bizneset më të vogla) dhe zakonisht kanë kërkesa të ndryshme rregullatore.

712 Aksionet e fondit të investimeve

Aksionet ose njësitë e fondit të investimeve (d.m.th, ato të emetuara nga fondet e investimeve) që dëshmohen nga letrat me vlerë dhe që nuk janë asete rezervë ose investime direkte përfshihen në investime portofoli. Megjithëse ato janë instrumente të negociueshme, derivativët financiarë të tregtuar në bursë nuk përfshihen në investime portofoli pasi ato përfshihen në kategorinë e tyre vetanake të veçantë.

713 Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë (më shumë se një vit)

Përfshijnë obligacionet, obligacionet e pagarantuara (debentures), letrat komerciale, dëftesat e borxhit, certifikatën e depozitave dhe letra me vlerë jo të ekuitetit të tregtueshme të tjera përveç derivativëve financiar. Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë përfshijnë instrumentet e emetuara me maturime origjinale mbi 12 muaj të ofruara nga jorezidentët për rezidentët dhe anasjelltas.

714 Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër (1 vit ose më pak)

Përfshijnë obligacionet, obligacionet (premtimet) e pagarantuara (debentures), letrat komerciale, dëftesat e borxhit, certifikatën e depozitave dhe letra me vlerë jo të ekuitetit të tregtueshme të tjera përveç derivativëve financiarë. Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër përfshijnë instrumentet e emetuara me maturime origjinale nën 12 muaj të ofruara nga jorezidentët për rezidentët dhe anasjelltas.

DERIVATIVËT FINANCIAR

810 Kontratat paraprake (ang. forwards)

Kontrata e së ardhmes (Forwards) është një kontratë e pakushtëzuar me të cilën dy kundërpalë bien dakord të shkëmbejnë një sasi të caktuar të një artikulli themelor (real ose financiar) me një çmim kontraktues të rënë dakord (çmimi i goditur) në një datë të specifikuar.

812 Opsionet, kontratat e së ardhmes (ang. futures), garancitë, shkëmbimet, etj

Në një kontratë opsionesh (opsion), blerësi merr nga shitësi të drejtën për të blerë ose shitur, varësisht se a është opsioni “blej” ose “shit”, një artikull themelor të specifikuar me një çmim të goditur në një datë të specifikuar ose para kësaj date .

Konvertimi i borxhit (kundërkëmbimi) është një shkëmbim i borxhit, zakonisht me një zbritje për një pretendim jo-borxhi siç është ekuiteti, ose për fonde kundërpale që mund të përdoren për të financuar një projekt ose politikë të veçantë. Garancitë janë një formë e opsionit të derivativit financiar që i jep pronarit të drejtën, por jo detyrimin për të blerë nga emetuesi i garancisë një shumë fikse të një aseti themelor, siç është ekuiteti dhe obligacionet, me një çmim kontraktues të rënë dakord për një periudhë të caktuar kohore ose në një datë të caktuar.

INVESTIMET E TJERA

910 Ekuiteti tjetër që nuk është pjesë e ID-ve dhe IP-së

Ekuiteti tjetër është ekuitet që nuk është në formën e letrave me vlerë. Ekuiteti tjetër përfshihet në investime të tjera, kur nuk është investim direkt ose asete rezervë.

911 Depozitat

Depozitat përfshijnë të gjitha pretendimet që janë (a) mbi bankën qendrore, korporatat depozitamarrëse përveç bankës qendrore, dhe, në disa raste, njësi të tjera institucionale; dhe (b) të përfaqësuara nga dëshmia e depozitimit.

912 Huat afatgjata

Huat janë asete financiare që (a) krijohen kur kreditori i huazon fonde direkt një debitori, dhe (b) dëshmohen nga dokumente që nuk janë të negociueshme. Huat me kohëzgjatje prej më shumë se një vit konsiderohen hua afatgjata.

913 Huat afatshkurtra

Huat janë mjete financiare që (a) krijohen kur kreditori i huazon direkt fonde një debitori, dhe (b) dëshmohen nga dokumente që nuk janë të negociueshme.

914 Llogaritë e tjera të arkëtueshme/të pagueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme/të pagueshme përfshijnë avanset dhe pagesat e shtyra në lidhje me shkëmbimin e aseteve jo të prodhuara.

ASETET E RESERVËS

101 Ari monetar

Ari monetar është ari ndaj të cilit autoritetet monetare (ose të tjerë që i nënshtrohen kontrollit efektiv të autoriteteve monetare) janë titullarë dhe që mbahet në cilësinë e aseteve të rezervës.

102 Të drejtat speciale të tërheqjes/tirazhit (SDR)

SDR-të janë asete ndërkombëtare të rezervës të krijuara nga FMN-ja dhe të alokuara anëtarëve për të plotësuar rezervat ekzistuese zyrtare.

103 Pozicioni i rezervës në FMN

Pozicioni i rezervës në FMN është shuma e (a) e "transhit të rezervës", domethënë, shumat në valutë të huaj (përfshirë SDR-të) që një vend anëtar mund të tërheqë nga FMN-ja me një periudhë të shkurtër njoftimi paraprak; dhe (b) çdo borxh i FMN-së (nën një marrëveshje huaje) në Llogarinë e Resurseve të Përgjithshme që është lehtësisht në dispozicion për vendin anëtar, duke përfshirë huadhënien e vendit raportues ndaj FMN-së nën Aranzhimet e Përgjithshme të Huamarrjes (GAB) dhe Aranzhimet e Reja të Huamarrjes (NAB). Ndërkohë që një vend anëtar duhet të paraqesë një deklaratë të një nevoje të lidhur me bilancin e pagesave për të bërë një blerje të transhit të rezervës (zvogëlimi në pozicionin e rezervës), FMN nuk e kundërshton kërkesën e një anëtarit për blerje të transhit të rezervës. Valutat e konvertueshme nga një blerje e transhit të rezervës mund të vihen në dispozicion brenda ditëve.

104 Depozitat

Depozitat u referohen atyre që janë në dispozicion sipas kërkesës; mund të përfshihen depozitat me një afat të caktuar, të cilat janë të rikuperueshme sipas kërkesës ose me një periudhë shumë të shkurtër njoftimi paraprak, pa ndikuar panevojshëm mbi vlerën e depozitës. Depozitat e përfshira në asetet e rezervës janë ato që mbahen në bankat qendrore të huaja, BIS, dhe korporatat tjera jorezidente depozitamarrëse, dhe marrëveshjet e depozitave me Llogaritë e Trustit të FMN-së të cilat janë të thirrshme lehtësisht për të përmbushur një nevojë financimi të bilancit të pagesave.

105 Letrat me vlerë

Letrat me vlerë janë instrumente të borxhit dhe ekuitetit që kanë veçorinë karakteristike të negociueshmërisë. Në asetet e rezervës, letrat me vlerë përfshijnë ekuitetin likuid dhe të tregtueshëm dhe letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga jorezidentët; letrat me vlerë afatgjata (siç janë obligacionet e thesarit 30-vjeçare të Sh.B.A) janë të përfshira.

106 Pretendimet tjera

Pretendimet tjera përfshijnë huat për korporatat jorezidente jodepozitamarrëse, huat afatgjata për një llogari të Trustit të FMN-së, të cilat janë lehtësisht të ripagueshme për të përmbushur një nevojë financimi të bilancit të pagesave, huat që rrjedhin nga një repo e anasjelltë (përveç nëse klasifikohen si depozita), dhe asetet e tjera financiare që nuk janë përfshirë më parë por që janë asete në valutë të huaj e që janë në dispozicion për përdorim të menjëhershëm.

Shtojca 4: Kodet e vendeve (ISO 3166) dhe valutave (4217)

Shtojca 4: Kodet e vendeve

Vendi	Kodi	Vendi	Kodi	Vendi	Kodi	Vendi	Kodi
Belgjika	BE	Shqipëria	AL	Dominika	DM	Liberia	LR
Bullgaria	BG	Andorra	AD	Republika Dominikane	DO	Madagaskari	MG
Republika Çeke	CZ	Bjellorusia	BY	Salvadori	SV	Malavi	MW
Danimarka	DK	Bosnja dhe Hercegovina	BA	Grenada	GD		ML
Gjermania	DE	Ishujt Faroe	FO	Guatemala	GT	Mauritania	MR
Estonia	EE	Gjibraltari	GI	Haiti	HT	Mauritiusi	MU
Irlanda	IE	Guernsej	GG	Hondurasi	HN	Mozambiku	MZ
Greqia	GR	Selia e Shenjtë (Qytetshteti i Vatikanit)	VA	Xhamajka	JM	Namibia	NA
Spanja	ES	Ishulli i Mani	IM	Meksiko	MX	Nigeri	NE
Franca	FR	Xhersi	JE	Montserrat	MS	Nigeria	NG
Kroacia	HR	Maqedonia e Veriut	MK	Nikaragua	NI	Afrika e Jugut	ZA
Italia	IT	Moldavia	MD	Panamaja	PA	Ruanda	RW
Qipro	CY	Mali i Zi	ME	Shën Kits dhe Nevis	KN	Shën Elena	SH
Letonia	LV	Rusia	RU	Shën Luçia	LC	Sao Tome dhe Principe	ST
Lituania	LT	Serbia	RS	St Maarten	SX	Senegali	SN
Luksemburgu	LU	San Marino	SM	Shën Vincenti dhe Grenadinet	VC	Sejshellet	SC
Hungaria	HU	Turqia	TR	Trinidad dhe Tobagoja	TT	Siera Leone	SL
Malta	MT	Ukraina	UA	Turks dhe Ishujt Kaikos	TC	Somalia	SO
Holanda	NL	Algjeria	DZ	Ishujt e Virgjër të SHBA-ve	VI	Sudani	SD
Austria	AT	Egjipti	EG	Argjentina	AR	Sudani i Jugut	SS
Polonia	PL	Libia	LY	Bolivia	BO	Suazilandi	SZ
Portugalia	PT	Maroku	MA	Brazili	BR	Tanzania, United Republic of	TZ
Rumania	RO	Tunizia	TN	Kili	CL	Togo	TG
Sllovenia	SI	Angola	AO	Kolumbia	CO	Uganda	UG
Sllovakia	SK	Benini	BJ	Ekuadori	EC	Zambia	ZM
Finlanda	FI	Botsvana	BW	Ishujt Falkland	FK	Zimbabveja	ZW
Suedia	SE	Territori Britanik i Oqeanit Indian	IO	Gujana	GY	Bahreini	BH
Mbretëria e Bashkuar	GB	Burkina Faso	BF	Paraguaji	PY	Iraku	IQ
Islanda	IS	Burundi	BI	Peruja	PE	Kuvajti	KW
Lihtenshajni	LI	Kameruni	CM	Surinami	SR	Omani	OM
Norvegjia	NO	Kepi i Gjellbër	CV	Uruguaji	UY	Katari	QA
Zvicra	CH	Republika e Afrikës Qendrore	CF	Venezuela	VE	Arabia Saudite	SA
Kanada	CA	Çadi	TD	Emiratet e Bashkuara Arabe	AE	Samoa Amerikane	AS
Grenlanda	GL	Komoret	KM	Jemeni	YE	Guami	GU
Vendi	Kodi	Vendi	Kodi	Vendi	Kodi	Vendi	Kodi

Shtetet e Bashkuara	US	Kongo	CG	Armenia	AM	Ishujt e vogël periferikë të SHBA	UM
Anguilla	AI	Bregu i Fildishtë	CI	Azerbajxhani	AZ	Australia	AU
Antigua dhe Barbuda	AG	Republika Demokratike e Kongos	CD	Gjeorgjia	GE	Kokos (Ishujt Kiling)	CC
Aruba	AW	Xhibuti	DJ	Izraeli	IL	Ishujt Kristmas	CX
Bahamet	BS	Guinea Ekuatoriale	GQ	Jordania	JO	Ishulli Hërd dhe Ishulli Mekdonald	HM
Barbadosi	BB	Eritrea	ER	Lebanoni	LB	Ishujt Norfolk	NF
Beliza	BZ	Etiopia	ET	Territori Palestinez	PS	Fixhi	FJ
Bermuda	BM	Gaboni	GA	Siria	SY	Polinezia Franceze	PF
Bonaire, Shën Eustatius dhe Saba	BQ	Gambia	GM	Afganistani	AF	Kiribati	KI
Ishujt e Virgjër Britanikë	VG	Gana	GH	Bangladeshi	BD	Ishujt Marshall	MH
Ishujt Cayman	KY	Guinea	GN	Butani	BT	Mikronezia, Shtetet e federuara të	FM
Kosta Rika	CR	Guinea-Bisau	GW	Brunei	BN	Nauru	NR
Kuba	CU	Kenia	KE	Birmania	MM	Kaledonia e Re	NC
Kuraçao	CW	Lesoto	LS	Kamboxhia	KH	Zelanda e Re	NZ
Kina	CN	Ishujt Kuk	CK	Nepali	NP	Tuvalu	TV
Hong Kongu	HK	Niue	NU	Korea Veriore	KP	Vanuatu	VU
India	IN	Tokelau	TK	Pakistani	PK	Samoa	WS
Indonezia	ID	Ishujt e Marianës Veriore	MP	Filipinet	PH	Uollis dhe Futuna	WF
Irani	IR	Palau	PW	Singapori	SG	Samoa Amerikane	AS
Japonia	JP	Papua Guinea e Re	PG	Korea Jugore	KR	Guami	GU
Kazakistani	KZ	Pitkarn	PN	Shri Lanka	LK	US Minor Outlying Islands	UM
Kirgizistani	KG	Antartika	AQ	Taivani	TW	Australia	AU
Laosi	LA	Ishulli Buvet	BV	Taxhikistani	TJ	Kokos (Ishujt Kiling)	CC
Makao	MO	Gjeorgjia Jugore dhe Ishujt Jugorë Sanduic	GS	Tailanda	TH	Ishujt Kristmas	CX
Malajzia	MY	Tokat Franceze Jugore dhe Antarktike	TF	Timor-Leste	TL	Ishujt Hërd dhe Mekdonald	HM
Maldivet	MV	Ishujt Solomon	SB	Turkmenistani	TM	Ishujt Norfolk	NF
Mongolia	MN	Tonga	TO	Uzbekistani	UZ	Fixhi	FJ
Institucionet e Bashkimit Evropian (me përjashtim të ECB dhe ESM)	4A	Fondi Monetar Ndërkombëtar	1C	Vietnami	VN	Polinezia Franceze	PF
Banka Evropiane e Investimeve	4C	Mekanizmi Evropian i Stabilitetit (ESM)	4S	Pjesa tjetër e botës e paalokuar	W19	Organizatrat Ndërkombëtare (përveç inst. të BE)	9A
Mekanizmi Evropian i Stabilitetit (ESM)	4F						

Shtojca 5: Forma raportuese për SRTN



SISTEMI I RAPORTIMIT TË TRANSAKSIONEVE NDËRKOMBËTARE

(Version 4.0)

Emri i bankës:

Periudha raportuese

Numri i raportimit:

Kodi i Bankës

Data e raportimit

Personi përgjegjës

Menaxheri

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Formulari 1- Transaksionet vetanake të banës

Numri	Data e transaksionit	Numri i referencës	Emri i jo-rezidentit	Kodi ISIN	Kodi i vendit	Kodi i SRTN	Kodi brendshëm SRTN	Përshkrimi i transaksionit	Pagesat	Pranimet

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Formulari 2 - Transaksionet e klientëve të bankës (≥10,000 euro)

Numri	Data e transaksionit	Numri i referencës	Kodi i bankës	Emri i rezidentit	Numri i regjistrit	Emri i jo-rezidentit	Kodi i palës tjetër	Kodi i shtetit	Kodi i SRTN	Kodi brendshëm i SRTN	Përshkrimi i transaksionit	Pagesat	Pranimet

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Formulari 3 - Transaksionet e klientëve të bankës (<10,000 euro)

Numri	Data e transaksionit	Numri i referencës	Kodi i bankës	Emri i rezidentit	Numri i regjistrit	Emri i jo-rezidentit	Kodi i palës tjetër	Kodi i shtetit	Kodi i SRTN	Kodi brendshëm i SRTN	Përshkrimi i transaksionit	Pagesat	Pranimet

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Formulari 4 – Transaksionet e klientëve të bankës me kartela bankare

Numri	Data e transaksionit	Kodi i bankës	Emri i rezidentit	Rezidenca	Lloji i transaksionit	Kodi i shtetit	Emri i shtetit	ID e terminalit	Lokacioni	Pagesa	Pranime